

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

UZLET (VETMIA)

Imam Gazali

Prishtinë, 2017

Ihjaw Ulumid-din
Ringjallja e diturive fetare
Imam Gazali

Titulli i origjinalit:
Kitâbu Adâbi'l – Uzlet
Libri 16

Përgatiti dhe përktheu
Shenaj Zeneli

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

PARATHËNIE

Hamd (falënderim) i takon vetëm Allahut, që robëve të Tij të hairit e me zemër të pastër u dhuroi mirësinë më të madhe, duke i miqësuar me njëri-tjetrin.

Me mirësi hyjnore, Ai ua qetësoi zemrat, dhe ua largoi prej aty dashurinë e kësaj bote, duke ua zvogëluar dëshirën për stolisje dhe dëfrim në të.

Aq shumë ua zvogëloi këtë dëshirë, sa edhe i bëri që, duke u tërhequr në vetmi, bile duke braktisur edhe më të afërmit, të preferojnë *tefekkur* (të menduarit) rreth nurit të Allahut Teala dhe madhësisë së Tij.

Salat dhe selam zotërisë sonë dhe zotërisë së të gjithë Pejgamberëve, Muhammedit s.a.v.s., ehli bejtit dhe as'habëve.

Tani dije se: njerëzit nuk pajtohen se cila ka epërsi: *uzlet* (vetmia) apo shoqërimi me njerëz.

Secila ka dobitë dhe dëmet e saj, ani pse shumica nga abidët dhe zahidët kanë preferuar tërheqjen në vetmi, duke e konsideruar atë më të vlefshme se sa shoqërimin me njerëz.

Ky mendim nuk përputhet me atë që kemi shpjeguar rreth vlerës së shoqërimit, miqësisë dhe vëllazërimit në librin *Edukata në miqësi*, prandaj, heqja e perdes nga hakikati rreth kësaj është detyrë e rëndësishme, e shpjegimi është i mundur në dy kapituj.

Kapitulli i Parë

MENDIME RRETH VETMISË

Mospajtimet rreth vetmisë (*uzlet*) kanë filluar në kohën e taibinëve, ani pse shumica e taibinëve kanë preferuar shoqërimin me njerëz, miqësinë e vëllazërinë, respektin, ndihmesën në çështje të fesë dhe mirësjelljen mes vete.

Ndërsa Sufjan Sevriu, Ibrahim ibn Ed'hemi, Davud Tai, Fudajl b. Ijad, Sylejman Havas, Jusuf b. Evsad, Huzejfe Merash dhe Bishr Hafiu, e që nuk janë nga taibinët, kanë preferuar vetminë (*uzlet*).

Përsëri një xhemat tjetër si Said b. Mysejeb, Shabi, Ibn Ebi Lejla, Hisham b. Urve, Ibn Shibrim, Sherik b. Abdullah, Ibn Ujejne, Ibn Mubarek, Imam Shafi dhe Ahmed b. Hanbel kanë preferuar shoqërimin me njerëz.

Transmetimet nga dijetarët lidhur me këtë çështje mund të mblidhen në dy pjesë:

E para: padiskutueshëm preferojnë njërin prej këtyre dy xhemateve; dhe

E dyta: preferojnë njërin xhemat, duke i shpjeguar shkaqet (sebep).

Ne, për të sqaruar çështjen, do të tregojmë dëshmitë, pastaj edhe dobësitë e këtyre dëshmimeve, të të dy xhemateve. E sipas transmetimeve:

Hazreti Omeri r.a., ka thënë:

“Merrni atë që ju takon nga vetmia.”

Ibn Sirini ka thënë:

“Vetmia është ibadet.”

E Fudajli ka thënë:

“Për dashuri të mjafton Allahu, për miqësi të mjafton Kur’ani, e për këshillë të mjafton vdekja.”

Gjithashtu është thënë:

“Bëhu mik me Allahun e braktis njerëzit.”

Ebu Rebi Zahid kërkoi këshillë nga Davud Tai, e ky i tha:

“Agjëro nga kjo botë, e bën iftar në ahiret. (do të thotë; braktis dynjallëkun e puno për ahiret) Prej njerëzve ik, si prej luanit!”

Hasan Basriu ka thënë që nga Tevrati i ka mësuar përmendësh këto fjalë:

*“I biri i Ademit,
kur kënaqet me pak, bëhet i pasur.
kur largohet prej njerëzve, arrin selametin.
kur braktis dëshirat epshore, bëhet i lirë.
kur braktis xhelozinë, bëhet mirëbërës.
kur duron pak, e shijon kënaqësinë gjatë.”*

Vuheb b. Verd ka thënë:

“Neve na kanë mësuar që hikmeti (dituria) është dhjetë pjesë; nëntë pjesë janë heshtje, e pjesa e dhjetë është largimi nga njerëzit.”

Jusuf b. Muslimi i tha Ali b. Bekarit, i cili nuk dilte nga shtëpia:

- Si mund t'i qëndrosh kësaj vetmie?

Ali b. Bekari i tha:

- Në rini isha më i qëndrueshëm; ulesha me njerëz e hiç nuk flisja.

E Sufjan Sevriu ka thënë:

“Kjo është kohë e heshtjes, kohë e tërheqjes në shtëpi.”

Një dijetar tregon:

“Isha duke udhëtuar me një anije. Aty ishte edhe një i ri alevi. Për një javë sa ishim së bashku, ky i riu as nuk foli e as nuk u shoqërua me ne. E pyeta:

*- Pse nuk flet e as nuk shoqëroresh me neve?’,
e ai si përgjigje, më lexoi këtë poezi:*

***Nuk ka asgjë në dorë që humbja ta frikësojë,
Ky nuk ka brenga e nuk ka fëmijë.
Këtij rinia i ka kaluar, dituri ka fituar,
Tani qëllim ka heshtjen, tërheqjen në vetmi.”***

Ibrahim Nahi, i kishte thënë dikujt:

“Mëso dituritë e fesë, pastaj tërhiq në vetmi”, e edhe Ebi b. Hajsemi njëjtë ka këshilluar.

Gjithashtu tregohet se Malik b.Enesi shoqërohej me miq, merrte pjesë në namaze të xhenazes, vizitonte të sëmurët. Por, ngadalë i braktisi të gjitha, e kur e pyetën për këtë, tha:

“Nuk është e drejtë që njeriu të tregojë secilën arsye të veten.”

I thanë Omer b. Abdulazizit:

- Sikur të ndaje pak kohë edhe për neve,

e Omeri u tha:

- Tashmë nuk ka asgjë për mua, përpos takimit me Allahun.

Fudajl b. Ijad ka thënë:

“Jam i kënaqur me atë i cili nuk më përshendet kur takohemi dhe nuk më viziton kur jam i sëmurë.”

Ebu Sulejman Darani tregon:

“Rebi b. Hajsemi rrinte nganjëherë për pak kohë para derës dhe shikonte përreth. Një ditë, deri sa po ulej para derës, një gur i hedhur e qëlloi në ballë dhe filloi t’i rrjedhë gjak. Hasejmi, duke e fshirë gjakun, tha:

- Shih Rebi, ky gur të dha mësim; mos dil më te dera.

Hyri në shtëpi e nuk doli jashtë deri në vdekje.”

Sad b. Ebi Vakas dhe Said b. Zejdin, kah fundi i jetës së tyre u tërhoqën në shtëpitë e veta në lagjen Akik të Medines, dhe përpos për xhuma, deri në vdekje nuk zbritën në qytet.

Jusuf b. Esbati tregon se Sufjan Sevriu ka thënë:

“Pasha Allahun, ka ardhur koha e vetmisë.”

Edhe Bishr b. Abdullahu ka thënë:

“Mos u njoftoni me shumë njerëz, ju nuk e dini se çfarë do të jetë dita e gjykimit. Nëse poshtërohesh, të paktën pak njerëz të njohin.”

Një vali (gubernator) vizitoi Hatemi Esammin, e i tha:

- *Nëse keni nevojë për diçka, më trego, dhe menjëherë e zbatojmë.* Hatemiu i tha:

- *Po kam, zbatoje menjëherë: as ti nuk do të më shohësh më, as unë ty, as ti nuk më njeh, e as unë ty.*

Dikush i tha Shehl Tusterit:

- *Dua të bëhëm mik me ty, e Shehli e pyeti:*

- *Kur të vdes njëri prej nesh, kush i bën shoqëri atij që mbetet gjallë?*

- *Allahu, tha personi, e Shehli ia ktheu:*

- *Atëherë mundohu prej tash të bëhesh mik me Allahun.*

Kur i treguan Fudajlit që djali i tij Alia ka thënë: *“Sikur të isha në një vend, ku unë shoh njerëzit por ata nuk më shohin mua”*, duke qarë, tha:

- *Vaj për Alinë, pse nuk thotë: ‘Sikur të isha në një vend ku as unë nuk shoh njerëz e as ata nuk më shohin mua’.*”

Fudajli gjithashtu ka thënë:

“Dëshira për të qenë i njohur prej shumë njerëzve vjen nga mungesa e zgjuarsisë.”

Ibn Abbas r.a., ka thënë:

“Vendi më i mirë për të qëndruar është shtëpia jote, ku ty nuk të sheh kush, e as ti nuk sheh kënd.”

Pra, këto janë fjalët e atyre që preferojnë uzletin.

DËSHMITË E ATYRE QË PREFEROJNË SHOQËRIMIN DHE DOBËSITË E KËTYRE DËSHMIVE

Ata që preferojnë shoqërimin, si dëshmi i paraqesin këto ajete Kur’anore:

“E mos u bëni si ata që u ndanë dhe u përçanë...” 3-Ali Imran: 105,
dhe:

“...Ai i pajtoi zemrat tuaja...” 3-Ali Imran: 103

Këto janë nga dëshmitë që paraqesin ata që mendojnë se shoqërimi është më i vlefshëm se vetmia, por përfundimi logjik i tyre është i dobët, sepse ajetet falsin për ndasitë në njohjen e kuptimit të Kur’anit dhe të parimeve të shariatit.

E qëllim i vetmisë është të heq mendimin prej ndarjes që bëhet sepër për përçarje dhe stimulon armiqësinë, prandaj nuk ka asnjë segment në këto ajete, që ndalon vetminë (*uzlet*).

Ata paraqesin edhe këtë hadith si dëshmi:

“Besimtari është i afërt me të tjerët, dhe të tjerët janë të afërt me të. Nuk ka dobi në atë që nuk bashkon dhe nuk shoqërohet.”¹,por, edhe kjo dëshmi e tyre është e dobët, sepse ky hadith flet për ahlakun e keq që pengon shoqërimin, e jo për shoqërimin mes njerëzve me ahlak të bukur.

Ky grup i paraqet edhe këto hadithe si dëshmi:

“Ai që largohet një pëllëmbë nga xhemati, e ka hequr lidhjen e Islamit prej qafës së vet”,

“Largimi nga xhemati është si të vdesësh në xhahilet”²,dhe

“Kush e prish unitetin e myslimanëve kur janë ata në xhemat, ka hequr lidhjen e Islamit prej qafës së vet.”³por, edhe këto dëshmi janë të dobëta, sepse me shprehjen ‘*xhemat*’ në këto hadithe nënkuptohet xhemati i lidhur (unanimisht) për një imam.

Kundërshtimi i një xhemati të tillë sigurisht që është zullum, sepse ka nevojë për një imam rreth të cilit mbledhen myslimanët, e kjo është e mundur vetëm me pranimin e imamllëkut të tij nga shumica e myslimanëve.

¹ Ahmedi dhe Taberani nga Sehla ibn Sa’di r.a., dhe Hakimi nga Ebu Hurejre r.a., që thotë se hadithi është sahih.

² Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

³ Taberani dhe Hattabi nga Ibn Abbasi.

Kundërshtimi i kësaj do të thotë ngatërrësë mes myslimanëve dhe zgjim i intrigës, e kjo sigurisht që është e ndaluar, por, këtu nuk ka asgjë kundër tërheqjes në vetmi - *uzletit*.

Ata i kanë paraqitur edhe këto hadithe si dëshmi:

“Kur personi është i hidhëruar mbi tri ditë me vëllanë mysliman, e vdes, ai hyn në zjarr.”⁴

“Nuk u lejohet myslimanëve të jenë të zemëruar mes vete mbi tri ditë. E, cili flet i pari, hyn në xhenet.”⁵

“Ai që është i zemëruar me vëllanë për një vit, bëhet si ai që i’a derdhë gjakun atij vëllai.”⁶

Duke i paraqitur këto hadithe si dëshmi për tezën e tyre, ata thanë se vetmia (*uzlet*) është braktisje e plotë e myslimanëve tjerë.

Edhe këto dëshmi të tyre janë të dobëta, sepse hadithet flasin për armiqësimin mes myslimanëve dhe mos-komunikimin mes tyre si pasojë e zemërimit, e nuk ka lidhje me *uzlet* - *tërheqjen* në vetmi.

⁴ Ebu Davud nga Ebu Hurejre.

⁵ Buhariu dhe Muslimi nga Enesi, e pjesa “...*cili flet i pari hyn në xhenet*”, në transmetim të Taberanit.

⁶ Ebu Davud nga Ebu Hirash Sulemi.

Bile, në dy raste, edhe zemërimi për më shumë se tri ditë është i lejuar: e para, si pritje për përmirësimin e gjendjes së personit në të cilin është zemëruar; dhe e dyta: gjetja e selametit në heshtje.

Sado që me hadith ndalohet qëndrimi në zemërim, këto dy raste bëjnë përjashtim nga rregulli.

Sipas transmetimit nga vet Ajsha r.anha, Resulallahu s.a.v.s., nuk ka folur me të në muajt Dhyl-hixhxe, Muharrem dhe disa ditë në muajin Sefer.⁷

E sipas transmetimit nga Omeri r.a., Resulallahu s.a.v.s., është tërhequr prej grave të tij në çardak për një muaj, e ka dalë pas 29 ditësh. Kur i thanë:

- *Ti nuk qëndrove një muaj, por 29 ditë,* Resulallahu s.a.v.s., tha:

“Nganjëherë muaji i ka 29 ditë.”⁸

Gjithashtu, në transmetimin e Ajshes r.anha, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Nuk e ka hallall myslimani të jetë i zemëruar më shumë se tri ditë me vëllanë, pos nëse vëllai është njeri i sherrit, atëherë i bëhet hallall.”⁹

⁷ Ebu Davud nga Ajsha r.anha.

⁸ Buhariu dhe Muslimi nga Omeri r.a.

⁹ Ibn Attij nga Ajsha r.anha.

Ky hadith dëshmon se ndarja lejohet. Edhe thënia e Hasan Basriut:

“Largimi nga budallai është afrim Allahut”,
interpretohet sipas këtij hadithi. E kjo vazhdon deri në vdekje, sepse budallai mbetet i tillë deri sa të vdesë. Budallallëku është sëmundje që nuk sherohet.

Kur i treguan Muhammed b. Omer Vakidit për një person që nuk kishte folur me një shok deri në vdekje, Vakidi tha:

- Kjo nuk është diçka e re. Ka edhe as’habë që kanë vepruar kështu. Sa’d b. Ebi Vakkasi deri në vdekje nuk ka folur me Ammer b. Jasir, as Osman b. Affani me Abdurahman b. Avf, as Ajsha me Hafsën, e edhe nga taibinët -Tavusi me Vehb b. Munebbihun nuk kanë folur mes vete deri në vdekje.”

E gjithë kjo është interpretuar si gjetje e selametit në heshtje.

Dëshmi tjetër e këtij grupi është edhe ky transmetim:

Në kohën e lumtur, një person kishte vendosur të tërhiqet në mal vetëm për ibadet. E sollën para Resulallahut s.a.v.s., e Resulallahu s.a.v.s, i tha:

***“As ti, e as tjetër kush të mos veprojë kështu!
Për secilin prej jush durimi në rrugë të Islamit është
më i hairit se sa 40 vjet ibadet në vetmi.”¹⁰***

Por, është e mundur që ky hadith të jetë thënë për periudhën e parë të Islamit, kur xihadi ishte farz, dhe kishte mundësi të braktiset xihadi, duke u tërhequr në ibadet. Këtë tezë e vërteton edhe hadithi më poshtë, që e transmeton Ebu Hurejre r.a.:

“Ishim me Resulallahun s.a.v.s., në luftë të shenjtë, arritëm në një luginë dhe aty gjetëm një burim uji të ëmbël Dikush mes nesh tha: ‘Do t’isha larguar nga njerëzit, dhe do t’i bëja ibadet Allahut në këtë luginë! Por jo pa e pyetur Resulallahun s.a.v.s.’ E Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- Mos vepro ashtu! Për secilin prej jush, lufta në rrugë të Allahut është gjashtëdhjetë vjet më e hairit se namazet e falura në shtëpi. A nuk dëshironi t’ju falë Allahu Teala e t’ju vendosë në xhenet? Luftoni në rrugë të Allahut, secilin që lufton (në rrugë të Allahut) edhe sa koha e një mjelje të deve¹¹, Allahu Teala e vendos në xhenet.”¹²

¹⁰ Bejhakiu nga As’as b. Selame. Disa thonë që hadithi është mursel. Edhe Ibn Hibban e transmeton si mursel në *‘Sukatu’t-Taibin’*.

¹¹ Shprehja *‘fevak’* e përdorur në hadith është rasti kur personi mjelë deven, më pas e lë të voglin e saj të thithë, dhe pastaj prapë e mjelë qumështin e mbetur.

¹² Transmetojnë Ahmedi dhe Taberani.

Si dëshmi kundër vetmisë (*uzlet*), është paraqitur edhe ky hadith që e transmeton Muadh b. Xhebel:

“Shejtani është për njeriun si ujku për delen; e rrëmben atë që largohet nga tufa... Edhe shejtani e rrëmben atë i cili largohet prej xhematit. Mos u ndani nga xhemati dhe xhamia, merrni pjesë në shoqëri.”¹³

Ky hadith ka për cak ata që dëshirojnë të tërhiqen në vetmi pa i mësuar dituritë, e këtë do të shpjegojmë hollësisht më vonë.

DËSHMITË E ATYRE QË PREFEROJNË VETMINË DHE DOBËSITË E KËTYRE DËSHMIVE

Këta e kanë paraqitur dëshminë se vetmia (*uzlet*) është më vlefshme me ajetin ku tregohet për Ibrahimin a.s.:

“E pasi u largua prej tyre dhe prej çka adhuronin ata pos Allahut, Ne i dhuruam atij Is'hakun dhe Jakubin dhe që të dy i bëmë pejgamberë.” 19-Merjem: 49

Po kuptohet që në ajet tregohet bereqeti dhe hairi i vetmisë (*uzlet*). E megjithatë, kjo si dëshmi është e dobët, sepse ajeti flet për qafirët. Hyrja mes qafirëve bëhet për t'i ftuar ata në besim. E kur

¹³ Tirmidhiu dhe Hakimi.

humbet shpresa e kthimit të tyre në fe, atëherë nuk mbetet tjetër pos ndarjes me ta dhe largimit prej tyre. E ne po flasim për shoqërimin me myslimanë dhe për përfitimet nga bashkimi dhe bashkëpunimi mes tyre.

Kur është pyetur Resulallahu s.a.v.s.:

- *A është më e pëlqyeshme të merret abdes prej një shtambe të mbyllur apo prej shatërvanit, ku merr abdes çdokush?*, Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Unë preferoj shatërvanin, sepse shpresoj në bereqetin e duarve të myslimanëve.**¹⁴

Është transmetuar se Resulallahu s.a.v.s., pasi që bëri *tavaf* Qaben, shkoi te burimi Zemzem për të pirë ujë. Aty pa një enë ku bëhej sherbeti i hurmes, e haxhitë pinin nga ajo. Resulallahu s.a.v.s., kërkoi ujë, e Abbasi r.a., tha:

- *Kjo është enë e sherbetit të hurmes. Njerëzit i fusin duart në të. Më lejo të të sjellë unë nga shtëpia ujë të pastër, në një shtambë të mbyllur.*

Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- **Më jepni edhe mua të pi nga ena ku të gjithë pinë. Duart e myslimanëve e tërheqin bereqetin**¹⁵, pastaj piu ujë Zemzemi nga ajo enë.

¹⁴ Taberani në veprën 'Evsat', nga Ibn Omeri.

¹⁵ Ezraki në veprën 'Historia e Mekkes' nga Ibn Abbasi.

Prandaj, si mund të barazohet largimi mes myslimanëve me largimin nga qafirët dhe idhujt e tyre? Këto nuk mund t'i bëhen dëshmi njera-tjetrës.

Ata që preferojnë vetminë e paraqitën si dëshmi edhe këtë ajet, ku Musa a.s., thotë:

“E nëse nuk më besoni, atëherë (bile) largohuni prej meje!” 44-Duhan: 21, pra, Musa a.s., është larguar prej tyre kur e ka humbur shpresën se ata do të besojnë, e kjo nuk mund të jetë argument për tezën e atyre që preferojnë vetminë.

E për *As’habi Kehf*, Allahu Tealathotë:

“Kur t’i lëni ju ata (popullin tuaj) dhe atyre që iu luteshin ata, përveç Allahut – (i thanë njëri-tjetrit): “Strehohuni në shpellë, Rabbi juaj do t’ju begatojë juve nga mëshira e Tij...” 18- Kehf: 16

Po kuptohet që atyre u është urdhëruar vetmia (uzlet). Edhe Sha’bi Ebi Talib është larguar në vetmi kur bënë dhunë të egër ndaj Resulallahut s.a.v.s.. Edhe Resulallahu s.a.v.s., urdhëroi largimin e as’habëve nga myshrikët në Habeshistan (Etiopi), të cilët vetëm pas përhapjes së Islamit u takuan në Medine. Të gjitha këto janë largim nga qafirët. Resulallahu s.a.v.s., nuk urdhëroi largimin nga myslimanët, por largim prej qafirëve për të cilët nuk kishte gjasë se do të ndryshonin. Edhe *As’habi Kehf* u larguan nga qafirët, nuk u larguan nga njëri-tjetri.

Ndërsa ne këtu po shqyrtojmë temën e largimit nga myslimanët.

Ky grup paraqet si dëshmi që vetmia është më e vlefshme edhe transmetimin e Abdullah b. Amir Xhehni. Abdullahu kishte pyetur Resulallahun s.a.v.s., se cilat janë zgjedhjet për shpëtim, e Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- **Qëndro në shtëpi, ndale gjuhën, dhe qaj për gabimet e bëra.**¹⁶

Gjithashtu, Resulallahu s.a.v.s., është pyetur:

- *Kush është më i virtytshmi?*, e ai, s.a.v.s., tha:

- **Besimtari (mumin) që me jetën dhe pasurinë e tij lufton në rrugë të Allahut.**

E në pyetjen:

- *Kush nga njerëzit është më me vlerë?*, Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Ai që tërhiqet në një mal e i bën ibadet Rabbit të vet, dhe nuk u bën dëm njerëzve.**¹⁷

Dhe me një hadith tjetër:

“Allahu Teala e do robin e devotshëm, të pasur dhe i fshehur nga njerëzit.”¹⁸

Duhet menduar para se këto hadithe të paraqiten si dëshmi për vlerën e vetmisë (uzlet). Sepse te hadithi rreth Abdullah b. Amir, it,

¹⁶ Tirmidhiu nga Akabe.

¹⁷ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Said Hudri.

¹⁸ Muslimi nga Sa'd b. Ebi Vakkasi.

Resulallahus.a.v.s., e ka ditur gjendjen e Abdullahut, dhe ka folur sipas gjendjes së tij. Përndryshe Resulallau s.a.v.s., askujt tjetër nuk ia ka këshilluar këtë. Ka disa njerëz që selameti i tyre nuk është në mesin e njerëzve, por në vetmi (uzlet). Ka shumë njerëz që selameti i tyre është qëndrimi në shtëpi dhe mos-pjesmarrja në luftë (xhihad). Gjendja e tyre nuk dëshmon se largimi nga lufta, si i tillë, është më i vlefshëm. Kurse, ka një lidhje mes shoqërimit me njerëz dhe xhihadit me nefsi. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Ai që përzihet me njerëz dhe i duron vështirësitë prej tyre, është më i hairit se sa ai që nuk përzihet me njerëz dhe nuk duron vuajtje prej tyre.”¹⁹

Në këtë kuptim duhet të lexohet edhe hadithi:

“Ai që është tërhequr në një mal e i bën ibadet Rabb-it të vet, dhe nuk u bën dëm njerëzve”,
pra ai që është i dëmshëm për njerëzit, më mirë është të tërhiqet në shtëpi dhe të bëjë ibadet.

Edhe hadithi:

“Allahu Teala e do robin e devotshëm, të pasur dhe i fshehur nga njerëzit”,
flet për largim nga fama; ka shumë priftërinj që janë tërhequr në vetmi por janë bërë të famshëm. E ka shumë myslimanë që nuk tërhiqen në vetmi, por nuk

¹⁹ Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe nga Ibn Omeri.

janë të famshëm, e as nuk u dihet emri. Pra, as ky hadith nuk ka lidhje me vetmi (uzlet).

Si dëshmi që vetmia është më e mirë, ky grup ka paraqitur edhe hadithin si vijon:

Një ditë Resulallahu s.a.v.s, u tha as'habëve:

- O as'habët e mi, a t'ju tregoj kush është mëi hairit nga njerëzit?

As'habët thanë:

- *Na trego, ja Resulallah (s.a.v.s.), e Resulallahu s.a.v.s., duke treguar me dorë drejt perëndimit, tha:*

- Më i hairit nga njerëzit është ai që mban në dorë frerët e kalit në rrugë të Allahut, që sulmon armikun, ose parandalon sulmin e tyre.

Pastaj duke treguar me dorë drejt Hixhazit, tha:

- ...dhe më i hairit nga njerëzit është ai që, derisa kullotë delet - falë namaz, jep zeqat, e di hakun e Allahut në pronën e tij, dhe largohet nga sherri i njerëzve.²⁰

Por, siç treguam më lartë, këto hadithe nuk mund të bëhen dëshmi të sigurt për asnjë grup; as për ata që perferojnë uzletin, as për ata që e kundërshtojnë. Prandaj duhet të shpjegohet mirë kjo çështje, duke e hequr perden, dhe duke i shpjeguar dobishmëritë dhe dëmet e vetmisë, që e vërteta të dalë në shesh.

²⁰ Taberani nga Ummu Mubeshiri, Tirmidhiu dhe Nesai nga Ibn Abbasi. Tirmidhiu ka thënë se hadithi është sahih.

Kapitulli i Dytë

SHPJEGIMI I DOBIVE DHE DËMEVE TËVETMISË

Dije se: mosmarrëveshjet lidhur me uzletin dhe shoqërimin janë të ngjashme me mosmarrëveshjet lidhur me beqarinë dhe martesën. Në *Librin për martesën*, ne i kemi shpjeguar dobitë dhe dëmet e saj, dhe si ato ndryshojnë, sipas rrethanave individuale. Edhe me *uzlet*, situata është e njejtë, prandaj, do t'i shpjegojmë së pari dobitë e vetmisë. Ato ndahen në dobi shpirtërore dhe të dynjallëkut.

Dobi shpirtërore janë angazhimi në vetmi me ibadet, zhvillimi i diturive duke menduar fuqinë dhe madhësinë e Allahut, ruajtja nga gjynahet ku mund të bie gjatë shoqërimit si dyfytërsia, thashethemet, braktisja e urdhërimit të mirës dhe për largim nga e keqja (*el-emr bil-ma'ruf ven-nehj anil-munker*), e të tjera, si edhe shpëtimi nga veset e këqija që mund t'i përvetësojë nga shoqëria e keqe.

Ndërsa dobitë e dynjallëkut janë se ushtron zanatin e vet i qetë, nuk anon kah luksi i kësaj bote, njerëzit nuk i bëjnë kërkesa, nuk i dalin në shesh gjendjet e fshehta, ruhet nga xhelozia, hipokrizia e mendimet e këqija, nga vështirësitë e njerëzve, si

edhe nga veset e ndryshme. Pra, ai që është i vetëm, i ka të gjitha këto dobi, e ne do t'i shpjegojmë ato në gjashtë pika:

DOBIA E PARË VETMISË

Dobia e parë është qetësia për ibadet e *tefekkur*; angazhimi për të hulumtuar fshehtësitë hyjnore, të kësaj bote dhe të ahiretit.

Për këto duhet qetësi. Shoqërimi me njerëz nuk e siguron këtë qetësi, kurse vetmia (*uzlet*) është mjet që krijon kushtet për të. Për këtë arsye disa nga dijetarët kanë thënë:

“Jeta vetmitare është e mundshme vetëm me përqaftimin e librit të Allahut.”

E ata që kanë përqaftuar librin e Allahut, kanë shpëtuar nga zënia e kësaj botë duke bërë dhikër. Ata që bëjnë dhikër Allahun, janë me Allahun. Ata jetojnë me dhikër, dhe vdesin duke përmendur Allahun. Me përmendje të Allahut, ata arrijnë pranë Allahut.

Padyshim që shoqërimi me njerëz pengon nga dhikri dhe mendimi. Për këtë, vetmia është më e mirë. Me këtë arsye, Resulallahu s.a.v.s., në filim u tërhoq në vetmi, në shpellën Hira. E kur u forcua me nurin e nubuvvetit, njerëzit më nuk ishin pengesë mes tij dhe Allahut. Ai ishte me trup mes njerëzve, por me zemër ishte drejtuar Allahut.

Njerëzit mendonin se Resulallahu s.a.v.s., më së shumti e do Ebu Bekrin r.a., e Resulallahu s.a.v.s, duke njoftuar që ai është i lidhur vetëm për Allahun, dhe që dashuria e vërtetë e Allahut Teala është në zemrën e tij, ka thënë:

“Nëse do të kisha marrë *halil* (mik të përzemërt), do të kisha zgjedhur Ebu Bekrin; por shoku juaj (s.a.v.s.) është *halil* i Allahut.”²¹

Është veçori e Pejgamberëve që të jenë me trup mes njerëzve e me zemër të Allahu.Njerëzit e rëndomtë nuk duhet të mendojnë se edhe ata mund të jenë kështu, ani pse disa nga evliatë mund të ngrihen në këtë gradë. Xhunejd Bagdadi ka thënë:

“Ka tridhjetë vite që unë i drejtohem Allahut, e njerëzit mendojnë se po u drejtohem atyre.”

Kjo i bëhet fat vetëm atij që me tërë qenien lidhet për Allahun, e nuk jep mundësi që në mes të hyjë kush. Kjo gjendje nuk duhet të mohohet.

Si shembull mund të marrim personin që është tepër i dashuruar, e i cili kur hyn mes njerëzve nuk dëgjon se çka flasin të tjerët, e as nuk është në dijeni se çka flet ai vet. Ai është plotësisht i preokupuar me dashurinë e vet.

²¹ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Said Hadri.

Bile, kur i dashuruari ndeshet me ndonjë vështirësi të kësaj bote, është aq i shpërqendruar sa që, edhe pse është mes njerëzve, nuk e sheh askë, dhe nuk dëgjon se çka flasin.

E për të mençurin, puna e ahiretit është më e rëndësishme. Në përgjithësi, për shumicën është më e përshtatshme të përfitojnë prej vetmisë. E kanë pyetur një mendimtar:

- *Pse tërhiqen njerëzit në vetmi?, e ju tha:*

- *Në vetmi, ata janë vazhdimisht në mendim dhe vendosin diturinë në zemër, e kështu arrijnë shijen e marifetit.*

Kur e kanë pyetur një abid:

- *Si e duron vetminë?, u tha:*

- *Unë nuk jam vet, jam me Allahun Teala. Kur dua që Allahu të më flasë, lexoj Kur'an, e kur dua që unë t'i flas Allahut, fali namaz.*

E kur njërin nga mendimtarët e pyetën:

- *Kjo rruga e vetmisë, deri ku dërgon?, ai u përgjigj:*

- *Deri në miqësi me Allahun.*

Sufjan b. Ujejne tregon:

- *"E takova Ibrahim b. Et'hemin në Sham, dhe e pyeta pse u largua nga Horasani, e ai më tha:*

- *Vetëm këtu gjeta qetësi. Për shkak të intrigës, largohesha nga një mal në tjetrin, e kush më shihte thoshte: 'Ky është dyshues, ose hamall, argat'."*

I thanë Gazvan Rakkashit:

- *Hajde po pranojmë që nuk qesh por, pse së paku nuk shoqërohesh me të tjerët?*, e Gazvani u tha:

- *Sepse në vetmi gjeta qetësinë shpirtërore.*

Hasan Basriut i thanë:

- *O Ebu Said! Këtu vjen një person, gjithmonë ulet i vetëm në këtë dru, dhe nuk flet.*

- *Më lajmëroni kur të vijë prapë*, u tha Hasani. Personi erdhi, dhe u ul në të njëjtin vend. E lajmëruan Hasanin, ky iu afrua, dhe e pyeti:

- *O rob i Allahut, po shoh që e do vetminë; pse nuk shoqërohesh me njerëz?* Personi i tha:

- *Ka diçka që më pengon të shoqërohem me njerëz.* Hasani i tha:

- *Këtu është njëri që quhet Hasan Basri, të paktën me të shoqërohu.* Personi i tha:

- *Ka diçka që më pengon të shoqërohem edhe me të.* Hasani i tha:

- *Allahu bëftë rahmet! Çka është ajo pengesë?*

Personi i tha:

- *Çdo mëngjes dhe mbrëmje Allahu më dhuron mirësi të panumërta, karshi të cilave unë jam me plot gjynahe. Po mundohem që të paguaj për mirësitë me falënderim, dhe për gjynahet me pendim. Prej se e kam kuptuar që kjo është më e rëndësishme se*

shoqërimi me njerëz, me askë nuk dëshiroj të shoqërohem. Atëherë Hasan Basriu i tha:

- O rob i Allahut! Ti je më i ditur dhe më fakih se Hasani, vazhdo në këtë rrugë.

Sipas transmetimit, Harm b. Hajani (evlia i njohur) erdhi te Uvejs Karani. Ky e pyeti:

- Pse erdhe?

- Të krijoj miqësi me ty, i tha Hajani.

- Unë nuk di për ndonjë person që e njeh Allahun, e kërkon të krijojë miqësime të tjerët, ia ktheu Uvejsi.

Fudajli ka thënë:

“Kur bëhet natë, gëzohem që mbetem vetëm me Rabbin tim, e ditën strehohem te Ai nga shoqërimi me njerëz, që do të më pengojnë të jem me Të.”

Abdullah b. Zejd ka thënë:

“Sa lumturi për atë që jeton edhe në dynja edhe në ahiret!” E kur e pyetën si arrihet kjo, tha:

- Deri sa është në dynja, vazhdimisht e përkujton Allahun Teala dhe i lutet Atij, e kështu arrin rahmetin e Tij.

Zunnun el-Misri ka thënë:

“Gëzimi dhe kënaqësia e besimtarit vjen nga përulja e tij Rabbit të vet.”

E, Malik b. Dinar ka thënë:

“Ai që në vetmi nuk merr kënaqësi nga ibadetet, ai di pak, zemra e tij është e verbër dhe jeta i ka kaluar bosh.”

Ibn Mubarek ka thënë:

“Në sa gjendje të mirë janë ata që i janë drejtuar Allahut!”

Njëri prej salihëve²² tregon:

“Po shëtisja afër Shamit, e u ndesha me një abid që kishte zbritur nga mali. Kur më pa, u mundua të fshehet pas një druri.

I thash:

- Subhanallah, je aq vetjak sa nuk lejon as të takohemi?, e ai mu përgjigj:

- O njeri... Ka shumë vite që jetoj në këtë mal, i vetëm, për t'iu drejtuar Allahut me tërë qenien time. E këputa interesimin për dynjallëk dhe për njerëzit e saj, dhe durova shumë - e shterra jetën. Iu luta Allahut që të më shpëtojë nga përpekja e përmirësimit të zemrës për këto ditë të mbetura në dynja. Allahu Teala më arriti zemrën në qetësi dhe

²² Salih[a] (prej Salah): i hairit; i mirë; është si duhet të jetë; ai që posedon drejtësi dhe veprime të drejta; ai që ka itikat; fetar; ai që i zbaton urdhrat e din-it; njeri i çmuar dhe i nderuar; ehli-takva; me virtyt; me dinjitet; i thuhet atij që është i ndershëm dhe bamirës.

vetmia m'u bë kënaqësi. Kur të pashë, u frikësova që do të kthehem në gjendjen e vjetër! Largohu prej meje, unë strehohem te Rabbi i botëve prej sherrit tënd. Pastaj më zë të lartë tha:

- Vaj për mua nga qëndrimi i gjatë në këtë botë! Ktheu fytyrën prej meje, dhe duke më shtrënguar dorën, tha:

- Ej dynja! Largohu prej meje, shko stolisu për ata që ty të dëshirojnë dhe mundohu ata t'i mashtrosh. Pastaj e shtoi edhe këtë:

- Allahu Teala është i pastër dhe i plotëfuqishëm që vendos në zemrat e evliave lezetin e dhikrit e ibadetit dhe dashurinë e vetmisë!, e duke thënë:

- Kuddusu, kuddusu, u largua prej aty."

Po kuptohet që me tërheqje në vetmi krijohen mundësitë për shoqërim me dhikër dhe përfitim të marifetit.

Lidhur me këtë, është thënë:

"Bëj se po flej; ndoshta e arrij ëndrrën. E largohem prej njerëzve; ndoshta më ndodhë takimi shpirtëror."

E për këtë, njëri nga dijetarët ka thënë:

"Njeriu pa virtyte dhe i papjekur e urren vetminë, e duke u shoqëruar me njerëz mundohet të ikë nga ajo që urren. E njeriu i virtytshëm e kërkon vetminë, sepse vetmia ndihmon mendimin për të përfituar dituri dhe hikmet."

Është thënë:

“Shoqërimi me njerëz është shenjë e dështimit.”

Pra, në vetmi ka shumë dobi, por jo për secilin.

Vetmia është e vlefshme për atë që me dhikër të vazhdueshëm përfiton miqësinë e Allahut, ose që me *tefekkur* (mendim) të vazhdueshëm arrin të vërtetat e marifetit. Qëllim dhe rezultat i ibadetit është njohja e Allahut, dhe kalimi në ahiret i dashuruar në Të.

Dashuria përfitohet me miqësi; ajo është arritje e dhikrit të vazhdueshëm, kurse marifeti arrihet me *tefekkur* të vazhdueshëm.

Për të dyja këto arritje, kusht është pastrimi dhe rehatia e zemrës. E kjo nuk sigurohet gjatë shoqërimit me njerëz.

DOBIA E DYTË

Dobia e dytë e vetmisë është shpëtimi nga gjynahet që mund të lindin në shoqërim me njerëz.

Këto gjynahe janë katër llojesh: gijbet²³, intriga (*nemime*), dyfytirësia (*rija*), dhe braktisja e urdhërimit të së mirës dhe ndalimit të së keqes (*emr-i bi'l-ma'ruf ven-nehj-i ani'l-munker*).

²³**Gijbet:** thashetheme; përgojim; kritikë *pas shpine*; të folurit kundër personit që nuk është prezent. Nëse ajo që thuhet është gënjeshtër, kurse personi është prezent, i dëgjon fjalët dhe ofendohet, atëherë llogaritet edhe gijbet edhe shpifje, pra – gjynah i dyfishtë.

Kur të mësosh për të keqen e thashethëmeve (gijbet) në librin *Dëmet e gjuhës*, do ta kuptosh se sa e vështirë është ruajtja nga to gjatë shoqërimit me njerëz, dhe është shpjeguar se nga kjo shpëtojnë vetëm siddikët (të sinqertit), sepse shumica e njerëzve e kanë adet të merren me thashethëme.

Njerëzit marrin kënaqësi nga thashethëmet dhe shoqërohen me të tjerët për atë qëllim.

Nëse bashkohesh me ta dhe merr pjesë në thashethëmet e tyre, bëhesh gjynahqar si ata dhe përballesh me zemërimin e Allahut. Edhe nëse hesht, prap je ortak i tyre, sepse ai që i dëgjon thashethëmet sikur t'i ketë thënë vet.

Nëse i kundërshton duke u thënë: *Çfarë është kjo që jeni duke bërë?*, ata të hidhërohen dhe braktisin thashethëmet e vjetra, e fillojnë të flasin për ty, pas shpinës tënde. Kështu, ata bëjnë thashethëme mbi thashethëme. Bile e teprojnë duke u tallur dhe fillojnë të flasin edhe fjalë të këqija.

E sa për *emr-i bi'l-ma'ruf ve'n-nehj-i ani'l-munker* ('urdhërimin për vepra të mira dhe për ndalim nga e keqja'), kjo është farz, dhe është një nga kushtet e fesë, siç edhe do të shpjegojmë në fund të kësaj pjese.

Ai që hyn në mesin e njerëzëve nuk ka mundësi të mos shoh ndonjë të keqe. Nëse hesht, kundërshton urdhrat e Allahut, e nëse mundohet t'i

parandalojë, përballet me të këqija tjera. Nganjëherë, duke menduar që të shpëtojë nga të këqijat, ndodh që hyn në gjynah edhe më të madh.

E në vetmi është shpëtimi nga këto. Braktisja e farzit të *'emr-i bi'l-ma'ruf ven-nehj-i ani'l-munker'* është i lehtë por sjellë pasoja, ndërsa zbatimi i këtij urdhëri është i vështirë.

Hazreti Ebu Bekr r.a., me një hutbe tha:

- O njerëz, ju po lexoni ajetin:

“O ju që besuat, ruajeni veten tuaj! Ai që ka humbur, nuk ju dëmton juve kur jeni në rrugë të drejtë.” 5-Maide: 105, *por po e përdorni në kuptim tjetër. Unë e kam dëgjuar Resulallahun s.a.v.s., duke thënë:*

“Kur njerëzit e shohin një të keqe e nuk e parandalojnë, frika është që të gjithë ata pësojnë nga dënimi i Allahut.”

Por, Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“(Në ditën e kiametit) Allahu Teala e pyet robin:

- Kur shihje ndonjë të keqe në dynja, pse nuk e parandaloje? Allahu Teala i'a mëson edhe përgjigjen robit e robi thotë:

- O Rabb! Unë shpresova në rahmetin Tënd. Nga njerëzit frikësohesha, prandaj heshta.”²⁴

²⁴ Ibn Maxhe nga Said el- Hudri.

Kjo është një situatë kur personi përballet me dajak ose kur nuk i mjafton fuqia. Përcaktimi i kufirit këtu është i vështirë dhe i rrezikshëm, ndërsa tërheqja në vetmi është shpëtim.

Gjithashtu, *'emr-i bi'l-ma'ruf ve'n-nehji - ani'l-munker'* mund të nxisë urrejtje dhe armiqësi.

Prandaj poeti ka thënë:

***'Sa shumë ka vaz e këshillime
që lindin armiqësi e thashetheme.'***

Ai që ka përvojë me *'emr-i bi'l-ma'ruf ve'n-nehji-ani'l-munker'*, shpesh bëhet pishman, sepse *'emr-i bi'l-maruf dhe nehji-ani'l-munker'* është si muri i shtrembër: duke dashur ta drejtosh – mund të shembet mbi ty. E nëse shembet, ti mendon: *"Sikur të mos e prekja fare."* Mund edhe ta drejtosh, nëse të ndihmon dikush duke i mbajtur qoshet, e ti e përforcon direkun. Por, ndihmës të tillë sot nuk ka. Prandaj, braktise këtë dhe provo të shpëtosh veten.

Dyfytyrësia (*rija*) është sëmundje kronike, që shërohet me vështirësi. Nga kjo sëmundje shumë vështirë shpëtojnë edhe *ebdal*²⁵ dhe *evtad*.²⁶

²⁵Ebdal: grupi i evliave. Thonë që janë shtatë, katërdhjetë ose shtatëdhjetë.

Secili që shoqërohet me njerëz, u buzëqesh atyre. Ai që u buzëqesh të gjithëve nuk mund të shpëtojë nga dyfytërsia. E ai që merr pjesë në dyfytërsinë e njerëzve e zë sëmundja e tyre, dhe siç shkatërrohen ata, edhe ky shkatërrohet.

E nga dyfytërsia, më së paku që lind është grindja. Sepse kur takohesh me dy persona që janë armiq të njëri-tjetrit, nëse nuk u përshtatesh mendimeve të të dyve - mund të bëhesh armik me të dy.

E nëse u bën lajka të dyve dhe sillesh miqësor, bëhesh njeriu më i keq.

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Më i keqi prej njerëzve është dyfytërsia. Ata te një njeri shkojnë me një fytyrë, e te tjetri me fytyrë tjetër.”²⁷

Kur njeriu merr pjesë në shoqërim, ai gjoja shfaq interesim për të tjerët, e pastaj edhe e zmadhon këtë. I tilli nuk mund të shpëtojë nga gënjeshtria, goftë në esencë, ose me zmadhimin e saj. Për

²⁶Evtad: janë katër persona që gjinden në secilin shekull. As nuk shtohen e as nuk pakësohen. Shejh-i Ekber tregon:

“E takova njërin prej tyre në Kudus. Quhej Ibn Xh’dun. Ata kanë për detyrë mbrojtjen e lindjes, perëndimit, veriut dhe jugut. Ibn Xh’dun ishte mbrojtësi i lindjes, e të tjerët janë Abdulhaj, Abdulmurid dhe Abdulkadir.

²⁷Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a..

shembull, kur pyet: *“si jeni, si e keni familjen”,* ndërkaq as që i intereson gjendja e tij.

Sejri Sakati ka thënë:

“Nëse një shok është duke më ardhë në vizitë, e unë mundohem të rregulloj mjekrën me dorë, frikësohem se do të regjistrohem në fletoren e munafikëve.”²⁸

Fudajl b. Ijaz ishte duke u ulur vet në Mesxhidi Haram.

I erdh një shok, e Fudajli e pyeti:

- *Pse erdhe?* Shoku i tha:

- *O Ebu Ali! Kam ardhur të shoqërohem me ty.*

Fudajli i tha:

- *Vallahi, ky veprimi joti po më duket shumë i egër. Kjo na detyron në ndarje, si përfundim i fjalëve të zbukuruara dhe gënjeshtreve të ndërsjella; ato janë më shumë egërsi se sa miqësi.”*

Njëri prej dijetarëve ka thënë:

“Kur Allahu Teala e do një person, Ai dëshiron që personi mos t’a dijë se është i dashur i Tij.”

Tavus hyri te Halife Hishami dhe i tha:

- *O Hisham! Si jeni?*

Hishami u zemërua, dhe i tha:

²⁸Munafik: dyfytërësh; fitnexhi; ngatërrestar; përcarës.

- *Pse më thirre me emër, e nuk më the: ‘o Emiru’l- mu’minin.*²⁹?

Tavus-i i tha:

- *Sepse jo të gjithë myslimanët kanë pranuar halifatin tënd. Nuk t’u drejtova me titullin që ti do, nga frika se do të bëhëm gënjeshtar.*

Kush nuk mund ta ruaj veten në këtë mënyrë, ai duhet të tërhiqet në vetmi. Përndryshe duhet ta pranojë se emri i tij do të shënohet në listën e munafikëve.

Të vjetrit (*selefi salihin*), për t’u shmangur nga dyfytërsia kur takoheshin mes vete, ishin shumë të kujdesshëm me pyetjet “*si je*” e “*si e ke hallin*”, dhe me përgjigjet në to. Ata njëri-tjetrin e pyesnin për çështjet e fesë, e jo për çështje të dynjasë.

Hatem-i Esamm e pyeti Hamid Lefaf-in:

- *Si je?*, e Hamidi u përgjigj:

- *Jam në shëndet e selamet.*

Hatemiu nuk i pëlqeu kjo përgjigje, dhe i tha:

- *O Hamid! Selameti është përtej urës së siratit, e shëndeti është në xhenet.*

²⁹ “*O udhëqehës i besimtarëve*”

Kur e pyetën Isën a.s.:

- *Si e kalove natën?, Isa a.s., u përgjigj:*

- *Në pafuqi për të larguar atë që nuk më pëlqen dhe për t'u bërë gati për atë që dëshiroj. Të gjitha mirësitë janë në dorë të tjetër kujt, nuk ka më i varfër se unë.*

E kur kështu është pyetur Rebi b. Hajsem, ky tha:

- *Si i dobët e gjynahqar, e ha riskun dhe e pres exhelin.*

Edhe Ebu Derdan e kanë pyetur si e kaloi natën, e Ebu Derda tha:

- *Nëse shpëtoj nga xhehenemi, e kalova me hair.*

E kur e kanë pyetur Uvejsi Karanin, Uvejsi ka thënë:

- *E si mund të kalojë njeriu kur, hyn në natë e nuk e di a do ta arrijë mëngjesin, dhe kur del në mëngjes nuk e di a do ta arrijë natën; ashtu e kalova.*

Malik b. Dinar është pyetur njëjtë, e ai ka thënë:

- *Në mes të jetës që pakësohet dhe gjynaheve që shtohen.*

E njëri nga dijetarët është përgjigjur:

- Duke dashuruar jetën dhe veten.

Një dijetar tjetër, për pyetjen e njëjtë, ka thënë:

- Në gjendje të tillë që - ha riskun e Rabbit tim, e i përulem shejtanit dushman.

E kur Muhammed b. Vasi është pyetur kështu, ai ka thënë:

- E çka mendon ti, si mund ta kalojë natën ai që çdo ditë i afrohet për një konak ahiretit?

Edhe Hamid Leffaf-in e pyetën si e kaloi natën, e ai u tha:

- Duke kërkuar shëndet për ditën që po vjen.

E pyetën:

- A nuk je çdo ditë në shëndet?”, e Hamidi tha:

- Shëndet është kur e kalon gjithë ditën pa kundërshtuar urdhrat e Allahut.”

E pyetën një person që ishte në shtratin e vdekjes: *“Si je?”, e ai u përgjigj:*

- E si mund të jetë personi kur, niset në rrugë të largët pa ushqim, do të hyjë në varr të shkretë pa frymë, e do të del pa fuqi para Sunduesit të drejtë?”

Kur e kanë pyetur Hasan b. Ebu Sinanin “*Si e ke hallin*”, ka thënë:

- *Si mund të jetë halli i njeriut kur, pas vdekjes ringjallet dhe jep llogari?!*

Ibn Sirini e pyeti dikë:

- *Si e ke hallin, e ai u përgjigj:*

- *Si mund të jetë gjendja e atij që ka shumë fëmijë, është fukara, e bile edhe në borxh, pesëqind dërhëmë!*

Me të dëgjuar këtë, Ibn Sirini shkoi në shtëpi, mori njëmijë dërhëmë, ia dërgoi atij njeriu, dhe i tha:

- *Merr pesëqind dërhëmë dhe ktheje borxhin, e pesëqind tjerat harxhoi për fëmijët.* E pas kësaj, Ibn Sirini, të cilit nuk i kishin mbetur para tjera, tha:

- *Vallahi, pas kësaj nuk do të pyes më për gjendjen e askujt.*

Kështu ka thënë nga frika se nuk do të mund të interesohet për dertet e tyre. Prandaj ata pyetjet i kishin më shumë rreth çështjeve të fesë, për gjendjen e zemrës dhe për zbatimin e urdhrave të Allahut. E kur kanë pyetur për dynjallëk, kanë pyetur për të shprehur gatishmërinë për ndihmë, kur ka qenë nevoja.

Dikush tregonte:

“Dikur kam njohur njerëz të tillë që rrallë takoheshin mes vete, por sikur njëri t’i thoshte tjetrit ‘Më jep gjithë pasurinë’, ky do t’ia jepte pa hezitim. E sot njoh njerëz që çdo ditë takohen, pyeten për çdo gjë, për gjendjen e pulave e të macës, deri edhe për gjilpërë e pe, por nëse njëri kërkon vetëm diçka prej tjetrit, ky nuk ia jep.”

Pyetjet në këtë mënyrë për gjendjen nuk janë asgjë tjetër përpos dyfityrësi dhe përçarje. Ja dëshmia:

Ti i sheh njerëzit çdo ditë duke i thënë njëri-tjetrit: *‘si je?’* e *‘si e ke hallin?’*. Të dytë e dinë që pyetjet nuk janë të sinqerta; ai që pyet nuk pret përgjigje dhe personi përballë nuk përgjigjet por i bën të njëjtat pyetje. Bile nganjëherë, kur zemrat janë të mbushura me urrejtje dhe xhelozë, edhe këto pyetje bëhen me maje të gjuhës.

E kur një person e pyeti Ebu Bekir b. Ijasin *‘si e kalove natën’*, Ebu Bekri i tha:

- Lëni këto bidate.³⁰

³⁰ Buhariu në veprën e tij ‘Sahih’ e paraqet këtë person si dëshmi. Është person i besueshëm, lexues i përmendur i Kur’anit, nga qyteti Kufe, ka vdekur në vitin H. 94, në moshën 100 vjeqare.

Hasan Basriu ka thënë:

“Selefi salihin-ët i kanë thënë njëri-tjetrit ‘Es-selamu alejkum ve rahmetullahi’, që zemrat t’ju gjejnë selamet. Por tani po thuhet: ‘si jeni?’, ‘si e kalove natën’, ‘Allahu të dhashtë shëndet’, ‘si e ke hallin’ e ‘Allahu të ndimoftë’. Nëse edhe ne veprojmë kështu, do të bëjmë bidat, sepse keramet (mrekulli) gjithsesi nuk është. Për këtë arsye ne nuk veprojmë si ata, edhe nëse ata nevríkosen.”

Hasan Basriu kështu tregon se është bidat të fillohet muhabeti me “si jeni”, “si e kalove natën”, apo “mirëmëngjes”.

Pyetja ‘si e kalove natën’ për herë të parë është dëgjuar kur është paraqitur sëmundja e murtajës në Sham, në fshatin Amevas afër Bejtul Makdis (Kudus).³¹Të sëmurët mes vete, dhe vizitorët që vizitonin të sëmurët e bënë këto pyetje në mëngjes, e në aksham pyesnin ‘si kalove ditën’. Pas kësaj, këto pyetje u përhapën.

Qëllimi i të gjitha këtyre transmetimeve është të tregohet se në shumicën e takimeve nuk shpëtohet nga dyfytërsia dhe përçarja. Të gjitha këto janë sjellje të qortuara, disa bile janë të papëlqyeshme (*mekruh*) e disa edhe të rrezikshme.

³¹ Sëmundja e murtajës mes myslimanëve është paraqitur për herë të parë në këtë vend, në kohën e hazreti Omerit r.a..

Në *uzlet* është shpëtimi nga të gjitha këto.

Ai që hyn në mesin e njerëzëve, nëse nuk përshtatet me adetet e tyre, ata qëndrojnë ftohtë ndaj tij, bëjnë thashetheme për të, e turpërojnë dhe e mundojnë. Për këtë arsye ata bëhen gjynaqarë e edhe ai, pasi të tentojë hakmarrje, bëhet gjynaqar.

Sa i përket përvetësimit të fjalëve dhe sjelljeve të një mjedisi, edhe kjo është një sëmundje e fshehtë dhe e rrezikshme. Jo vetëm të pavëmendshmit, por edhe i mençuri vështirë e shpëton veten nga kjo.

Për këtë arsye nuk duhet shoqëruar shumë me njerëz të këqij, sjellja e të cilëve nuk të pëlqen. Nëse shoqërohesh gjatë me njerëz të tillë, në vete sheh ndryshim.

Fillimisht këto sjellje nuk të pëlqejnë, por ngadalë mësohesh dhe më pas nuk tregon vëmendje për to. Ti më përpara qëndroje larg tyre sepse ato sjellje i konsidirojesi dëm. Dalngadalë, duke u mësuar me to, e nënvlerëson rrezikun e tyre, dhe në fund fillon t'u japësh rëndësi nga zemra.

Sidomos, kur sheh shumë gjynahe të mëdha, gjynahet e vogla më nuk të duken të rrezikshëm. Për këtë arsye, kur shoqërohesh me më të pasurit, veten e sheh pa vlerë dhe e nënçmon. E ai që shoqërohet me të varfrit, ia di vlerën asaj që posedon.

Njëjtë është edhe shoqërimi me besimtarin dhe pabesimtarin. Ky është një ndikim natyror.

Ai që mendon t'ju përshtatet as'habëve dhe taibinëve, ibadetet e veta i sheh të mangëta, e kur i sheh të mangëta, padyshim që përpiqet më shumë t'ju përshtatet atyre, duke u kujdesur dhe duke u munduar të shtojë ibadetet.

Por ai që shikon njerëzit që janë dalldisur pas kësaj bote dhe që kundërshtojnë urdhrat e Allahut, kurse veten e sheh mirë, atij fillon t'i pëlqejë vetja, dhe pikërisht kështu shkatërrohet.

Mjafton të dëgjohet për të mirën, ose të keqen, e të ndryshojë natyra. E kur edhe shikohet?

Me njohje të kësaj hollësie, kuptohet edhe fshehtësia e hadithit:

“Kur përmenden salihët zbret rahmeti.”

Rahmeti është hyrje ne xhenet dhe takim me Allahun.

Padyshim që një rahmet i tillë nuk zbret sapo të përmenden salihët, por në përmendjen e tyre gjendet sebepi i këtij rahmeti. Sebep është dëshira që vjen nga zemra, si kërkesë për t'ju përshtatur salihëve, duke u larguar nga veset dhe nga gjynahet. Sebep i rahmetit janë veprat e mira. Prirja për këto vepra është burim i mirësisë. E motiv për këtë prirje është përmendja e salihëve dhe përkujtimi i gjendjeve të tyre. Ky është pra kuptimi i hadithit:

“Kur përmenden salihët zbret rahmeti.”

Për të mençurin, kuptimi që del nga kjo shprehje është paralel me kuptimin që del nga e kundërta e saj: kur përmenden të mirët zbret rahmeti, e kur përmenden të këqijtë zbret mallkimi.

Përmendja e shpeshtë e të keqes dhe të këqijve ia letëson njeriut të bëjë keq, dhe kjo bëhet shkak për mallkim. E mallkimi do të thotë largim nga rahmeti i Allahut.

Filimi i largimit nga rahmeti është dalldisja në gjynahe, kundërshtimi i urdhrave të Allahut dhe kalimi i kufijve pas dynjasë dhe epshit.

Shkak për gjynahin është nënvlerësimi i tij. Shkak i nënvlerësimit është të dëgjuarit e shumë të për gjynahet me çka krijohet një lloj afërsie me të.

Kur vetëm dëgjimi për të mirët ose për të keqijtë ndikon kaq shumë, si ndikon atëherë kur i shikon dhe gjindesh mes tyre?

Duke qartësuar këtë, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Shoku i keq është si kaceku me ajër i kovaçit: edhe nëse nuk të djegin xixat e zjarrit, avulli i tij të njollos.”³²

Siç njollos ky avull i pistë rrobat e njeriut pa u vërejtur, edhe e keqja me letësi e pa u vërejtur hyn në zemër të njeriut.

³² Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Musa.

E Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Shoku i mirë është si shitësi i aromës së mirë; edhe nëse nuk lyhesh me aromën e tij, kur gjendesh pranë tij, përfiton nga aroma e tij e bukur.”³³

Për këtë arsye unë them se, të tregohet ndonjë gabim i dijetarit është gjynah për dy arsye:

Një arsye është gjynahu i gijbet-it (thashethemes). Dhe e dyta, që është edhe më e rëndësishme: tregimi i gabimit të dijetarit ua lehtëson përsëritjen e atij gabimi edhe atyre që dëgjojnë për të. Kur sheh tjetrin duke bërë gabimin e njëjtë, dhe e pyet: *“Çfarë je duke bërë?”*, ky menjëherë përgjigjet: *“Pse është kaq i çuditshëm gabimi im? Të gjithë bëjnë gabime të tilla. Bile, edhe dijetarët dhe abidët e bëjnë këtë.”*

Po të mos kishte dëgjuar që dijetarët dhe abidët bëjnë gabim të tillë, as ai nuk do t’i afrohej atij gabimi.

Ka shumë njerëz që janë dalldisur pas kësaj bote dhe që me zili mbledhin pasuri, e të dashuruar pas udhëheqësisë, fusin veten edhe më shumë në rrezik.

Ata bile mendojnë që as as’habët nuk janë larguar nga dashuria për udhëheqje. Shkojnë aq larg sa që përmendin si dëshmi situatën e hazreti Alisë r.a., me Muavinë. Besojnë që kjo përplasje

³³ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

mendimesh nuk është bërë për të vërtetën (hak), por vetëm për shkak të dashurisë për udhëheqje. E ky besim i gabuar ua lehtëson gjynahet që vijnë nga dashuria për udhëheqësi.

Natyra e keqe anon kah gabimet e largohet nga mirësitë. Të këqijat pranohen sepse nuk vlerësohen si të këqija. Kjo është mashtrim i shejtanit, e ata që largohen prej shejtanit, Allahu Teala kështu i cilëson:

“Të cilët i dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të mirën prej tyre.” 39-Zumer: 18

Edhe Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Ai që ulet e dëgjon hikmet (dituri), e pastaj vepron sipas pjesës së keqe nga ajo që ka dëgjuar, është si ai që shkon te çobani dhe kërkon prej tij një dele, e kur çobani i thotë: ‘zgjedh delen që të pëlqen’, ky e merr qenin.”³⁴

E ata që tregojnë gabimin e imamëve janë si ai që zgjedh qenin në kopenë e dhenëve.

Një tjetër rast që shpesh shihet dhe kështu humb rëndësinë tek njerëzit është ky:

Shumë njerëz, kur shohin dikë që nuk agjëron në Ramazan, e kërcënojnë dhe e ofendojnë, e të njëjtit janë indiferent ndaj atyre që nuk falin namaz. Ndërsa ka mendim që braktisja e vetëm një namazi është

³⁴ Ibn Maxh nga Ebu Hurejre.

kufër, bile ka edhe që thonë që i tilli duhet të mbytet.³⁵

Kurse, braktisja e agjërimit gjatë gjithë Ramazanit nuk vlerësohet kështu.

Namazi është obligim pesë herë në ditë, por për shkak të takimit të shpeshtë me ata që nuk falin namaz, braktisja e namazit është bërë e zakonshme.

Agjërimi është obligim një herë në vit, por për shkak se ata që nuk agjërojnë janë të pakët, menjëherë binë në sy.

I këtillë është ndikimi në zemër i asaj që shumë shikohet. Ja shembull: nëse një fakih vesh këmishë mëndafshi, ose vë në gisht unazë ari, ose pi ujë prej gotës së argjendtë (të gjitha këto të ndaluara për burra), kjo kundërshtohet dhe fakihu sulmohet fuqishëm. Por, nëse i njëjti fakih në një mexhlis (tubim) vazhdimisht flet thashethëme, për këtë askush nuk shqetësohet. E thashethëmet janë më të këqija se zinaja! Si u bënë ato më të pranueshme se veshja e këmishës nga mëndafshi!?

Pasi që ka shumë të tillë që flasin thashethëme, dhe ato dëgjohen kudo, ato janë bërë të pranueshme për zemrën.

Pra, mendoi mirë këto hollësi dhe ik prej njerëzve, ashtu siç ikë prej kafshës së egër!

³⁵ Sipas Imam Hanefisë, nuk është kështu.

Atë që mund ta dëgjosh dhe shohësh te njerëzit, vetëm se ta shton dëshirën për dynja, të bën të harrosh ahiretin, t'i lehtëson gjynahet dhe ta zbehë dëshirën për ibadet.

Nëse gjen nje shok që ta përkujton Allahun, mos u largo prej tij, konsideroje pasuri. Për njerëzit e mençur, një shok i tillë është pasuri.

Kuptoje që shoku i mirë është më i hairit se sa vetmia, e vetmia më e hairit se shoku i keq.

Kur e kupton këtë që jam duke e shpjeguar - mendo për vete, dhe nëse mund të kontrollosh gjendjen e personit me të cilin do të shoqërohesh, tashmë nuk ka frikë për ty se nuk mund të gjesh çka është më e hairit për ty: t'i afrohesh apo të largohesh prej tij.

Mosgjyko menjëherë se a do të jetë më e hairit vetmia apo shoqërimi. Për punët që kërkojnë shpjegim të hollësishëm, nuk është e drejtë të gjykohet shpejtë, me *po* ose *jo*. Haku i çështjeve si kjo është sqarimi i tyre.

DOBIA E TRETË

Dobia e tretë e vetmisë është shpëtimi i fesë dhe i vetes nga dalldisja në intriga, duke u larguar nga rreziku i intrigës. Sot ka shumë pak vende që nuk janë prekur nga fanatizmi, intriga dhe armiqësia.

Shpëtim nga kjo është tërhiqja në vetmi.

Abdullah b. Amr b. As tregon:

“Duke e shpjeguar intrigën, Resulallahu s.a.v.s., m’u drejtua, e më tha:

- Çka bën ti kur sheh njerëzit që luajnë fjalën e dhënë dhe nuk respektojnë amanetin, e janë bërë *kështu* (dhe tregoi dy gishta të ngatërruar).

- O Resulallah! Çfarë të bëj kur vijnë kohë të tilla?

- Rri në shtëpi, zotëroje gjuhën, merr atë që di, e lëre atë që nuk e di, merru me punët tua e mos u përziej në punët e njerëzve.³⁶

Nga Ebu Said el-Hudri r.a., transmetohet se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Do të vijë koha kur prona më e hairit për myslimanin do të jetë kopeja me dele. Myslimani merr delet, shkon në maje të malit dhe në vende me shi; për selametin e fesë shëtit nga mali në mal.”³⁷

E nga Abdullah b. Mas’udi r.a., transmetohet se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Do të vijë një kohë për njerëzit, kur besimtari mund ta ruajë fenë vetëm duke shëtitur prej një fshati në fshatin tjetër, prej një mali në malin tjetër, duke ikur si dhelpira – nga një shkëmb në tjetrin; ndryshe nuk do të mund ta ruajë. *Pyetën:*

³⁶ Ebu Davud dhe Nesai në *“El-Jevm ve’l-Lejle”*.

³⁷ Buhariu

- *O Resulallah! Kur do të ndodh kjo?*, e Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Atëherë kur nuk mund të sigurohet ushqimi pa kundërshtuar urdhrat e Allahut. Në atë kohë, beqaria është hallall. Ata thanë:**

-*Por ju na keni këshilluar martesën!*, e Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Kur vjen ajo kohë, njeriu do të shkatërrohet nga duart e nënës dhe babait. Nëse nuk ka prind, nga duart e gruas dhe fëmijës, nëse nuk i ka edhe këta, nga duart e akrobave. E pytën:**

- *Si mund të jetë kjo?*, e Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Ata do ta qortojnë për varfërinë dhe do të dëshirojnë atë çka ky nuk mund ta sigurojë, e ky do të lëshohet pas saj, me çka do ta humb imanin, e kështu do të shkatërrohet.**³⁸

Sado që ky hadith është i kuptueshëm rreth beqarisë, nga kjo nënkuptohet edhe tërheqja në vetmi, sepse beqaria nuk e ka problemin e sigurimit të kushteve të jetesës për familjen. Personi i martuar është i detyruar të hyj mes njerëzve për të siguruar kushtet e jetesës së familjes, dhe për këtë do të dalldiset në gjynah.

³⁸ Hattabi në *'El-Uzle'* nga Ibn Mesud r.a., në mënyrë të njëjtë, si edhe Bejhekiu në *"Ez-Zuhd"* nga Ebu Hurejre r.a..

Unë nuk po them që kjo kohë ka arritur tani, ndoshta ka arritur më përpara.

Prandaj Sufjani Sevriu ka thënë:

- *Ka ardhë koha e vetmisë (uzlet).*

Ibn Mesud r.a., tregon:

“Resulallahu s.a.v.s., po tregonte për kohët e fitnes³⁹ që do të vijjnë. E pyeta:

- *O Resulallah! Kur do të ndodhë kjo?, e Resulallahu s.a.v.s., tha:*

- **Atëherë kur njeriu nuk është i sigurt as nga shoku i vet. E pyeta:**

- *Nëse e arrij atë kohë, si të veprojmë? Çfarë më urdhëroni të bëj? Resulallahu s.a.v.s., tha:*

- **Zotëro me veten dhe hyj në shtëpi. Unë i thash:**

- *Çfarë të bëj nëse kjo gjendje hyn në shtëpi?, e Resulallahu s.a.v.s., tha:*

- **Hyj në dhomë. Unë i thash:**

- *Po nëse kjo gjendje hyn edhe në dhomë?, e Resulallahu s.a.v.s., tha:*

- **Hyj në xhami dhe bëj kështu (u mbështoll në rroba), e deri në vdekje thuaj: ‘Rabbi im është Allahu.’⁴⁰**

³⁹ngatërresë, intrigë

⁴⁰Ebu Davud

Në kohën e Muavisë, kur e kanë ftuar në luftë Sa'd b. Ebi Vakkas-in r.a., (djali i Omerit dhe djali i vëllait të Hashimit), ai ka thënë:

“Jo, nuk marr pjesë në luftë deri sa të më jepni një shpatë me sy e me gjuhë. Shpata duhet të shohë, e të më thotë: ‘ky është qafir’, e unë do ta vras,dhe duhet të thotë: ‘ky është besimtar’ e unë do ta tërheqi dorën prej tij...”, dhe duke vazhduar tha:

“...Ne dhe ju (në Islam), jemi si një karvan që ecën në një rrugë të qartë. Papritmas shpërthen një furtunë që shkakton rrëmujë, bëhët tym e pluhur, dhe rruga humbet. Në këtë rrëmujë, një pjesë e karavanit shkon në të djathtë, duke thënë se rruga është andej, e një pjesë tjetër në të majtë, duke thënë se rruga është këndej, dhe të dy grupet shkatërrohen. Grupi i tretë presin aty ku janë, dhe kur pushon furtuna e rruga çilet, ata vazhdojnë rrugën. Ky është dallimi mes neve e juve.”

Një xhemat që ishte në të njëjtin mendim me Sa'd b. Ebi Vakkasin, qëndruan në shtëpi deri sa u largua ngatërresa.

Kur i erdh lajmi Abdullah b. Omerit r.a., se hazreti Husejni ka marrë rrugën për Irak, udhëtoi për tri ditë, e kur e mbërrijti Husejnin, e pyeti:

- *Ku po shkon?* Husejni, duke i treguar një grumbull letra, i tha:

- *Po shkoj në Irak, këto janë letra të Irakianëve.*

Ibn Omeri i tha:

- *Nuk ka besnikëri në fjalët e tyre; dje ta vranë babanë! Mos shko, mos të mashtroni fjalët e tyre.*

Por, pasi që Husejni r.a., nuk dëgjoi, Ibn Omeri i tha:

- *Do të tregoj një hadith... dhe vazhdoi:*

- *Kur erdhi Xhebraili alejhisselam tek Resulallahu s.a.v.s., dhe e la Resulallahun s.a.v.s., të lirë për të zgjedhur dynjanë ose ahiretin, Resulallahu s.a.v.s., zgjodhi ahiretin. E ti je një pjesë prej Resulallahut s.a.v.s.. Vallahi, hilafeti ju takon vetëm juve dhe atë e merr më i hairit mes juve. Kthehu, mos shko.* Husejni i tha:

- *Secili do të përballet me paracaktimin e vet; unë nuk kthehem.* Në këtë, Ibn Omeri e përqafoi Husejinin, dhe duke qarë, i tha:

- *Allahut amanet, e lus Allahun të të ruaj nga burgosja dhe vdekja.*⁴¹

Në Medine ishin rreth dhjetëmijë as'habë, e në kohën e ngatërresës vetëm katërdhjetë kishin shpëtuar nga ngatërresa.

⁴¹ Taberani dhe Bezzar.

Tavus b. Kejsem nuk dilte nga shtëpia.

Atyre që e pyesnin përse, ua paraqiste si sebeb ngatërresën e kohës dhe mizorinë e imamëve.

Urve b. Zubejr bëri një shtëpi në vendin e quajtur Akik, dhe u tërhoq atje.

Kur e pyetën:

- *Përse e le mesxhidin (xhaminë) e Pejgamberit, e u mbylle në shtëpi?*

Urve tha:

- *E pashë që xhamitë e juaja janë bërë lodër, çarshia e juaj është mbushur me fjalë boshe, në gjuhën tuaj janë shtuar fjalët e fëlliqura, kurse këtu e gjeta selametin.*

Edhe nga ky shpjegim kuptohet se dobi e vetmisë është shpëtimi nga intriga dhe armiqësia.

DOBIA E KATËRT

Dobia e katërt e vetmisë është shpëtimi nga sherri i njerëzve.

Njerëzit vazhdimisht sjellin vuajtje e mundim, nganjëherë me kritikë pas shpine, nganjëherë fajësojnë dhe akuzojnë pa bazë, nganjëherë me gënjeshtër. Shumë herë, fjalët dhe veprimet tua që nuk mund t'i kuptojnë i mendojnë se janë gabim, dhe

këtë e ruajnë si pasuri për ta përdorur kundër teje, kur të gjejnë rastin.

E në vetmi është shpëtimi dhe ruajtja prej kësaj.

Për këtë arsye një dijetar i tha një dijetari tjetër:

- Do t'i mësoj dy vargje, më të hairit se dhjetë mijë dërhëmë.

- Mi mëso!, i tha tjetri, e dijetari ia lexoi:

Natën mos fol me zërin ngritur,

E ditën mos fol retë pa i soditur.

Sepse fjala, qoftë e bukur apo e shëmtuar, kur del nga goja, nuk kthehet më.

Kur personi hyn mes njerëzëve për të punuar me ta, shpëtimi nga xhelozia dhe nga mendimi i keq për të tjerët është i pamundur. Edhe ata mendojnë që ky është kundër tyre, që ushqen armiqësi dhe mashtrim ndaj tyre.

E Mutenebbiu ka thënë:

“Pranimi i mendimit të keq për të tjerët është ves i keq. Kur fillon armiqësi ndaj mikut me fjalët e armikut, njeriu bëhet si i hutuari që ka humbur rrugën në natë të errët.”

Gjithashtu është thënë:

“Shoqërimi me njerëz të këqij bëhet sepër për mendim të keq ndaj njerëzve të mirë”

Njerëzit kanë përjetuar shumë të këqija nga shokët me të cilët janë shoqëruar. Ne nuk do të hyjmë në hollësi, kurse në këto shpjegime shkurtimisht ka dëshmi për të gjithë.

Në vetmi është shpëtimi nga të gjitha këto. Shumica e atyre që kanë preferuar vetminë kanë treguar për këtë, kurse Ebu Derda r.a., ka thënë:

“Kur fiton përvojë me njerëz, largohesh prej tyre.”

Kjo fjalë e Ebu Derdas është transmetuar edhe si *hadith merfu*. E poeti ka thënë:

***Kush lavdëron njerëz pa i vënë në provë,
pas përvojës i qorton.***

Atëherë gjenë rehati në vetmi,

Të afërm a të largët, njerëzit nuk i do.”

Hazreti Omeri r.a., ka thënë:

Në vetmi është shpëtimi nga shoku i keq.

Kur e kanë pyetur Abdullah b. Zubejrin:

- *Pse nuk vjen në Medine?*, Abdullahu tha:

- *Pse të vij? Atje kanë mbetur vetëm njerëzit që
xhelozojnë të mirat e tjetrit dhe që i gëzohen
fatkeqësisë së tjetrit.*

Ibn Semmak (vaiz i njohur i Bagdadit) ka treguar:

*“Morra një letër nga një shok, e në letër
shkruante:*

- Njerëzit më parë kanë përdorur ilaç, por tani sëmundja e tyre nuk ka shërim. Ik prej tyre siç ikë prej luanit.”

Një beduin vazhdimisht ulej nën të njëjtën pemë, e ujiste dhe kujdesej për të.

E pyetën për sebebën e kësaj, e ai tha:

“Sepse kjo pemë i ka tri virtyte: nuk bën thashethëme për mua, nuk zemërohet edhe nëse e pështyj, dhe nëse i them ndonjë fjalë të keqe, nuk nevrifikohet.”

Kur dëgjoi për këtë, Harun Rashidi tha:

“Këto janë tri virtyte që kërkohen në miqësi.”

Edhe njëri nga selefitë është angazhuar me libra dhe vizitë varreve, e kur e pyetën për sebebën, tha:

“Unë e gjeta selametin në vetmi; këshilltari më e mirë është varri, e miku më i mirë është leximi.”

Hasan Basriu ka treguar:

“E bëra nijet të shkoj në haxh. Për këtë kishte dëgjuar Sabit Bennani, dhe më tha:

- Dëgjova që do të shkosh në haxh, dua që të jem shok me juve. E unë i thash:

- Allahu ju bekoftë, Allahu po na mbulon gabimet. Kemi respekt e dashuri për njëri-tjetrin. Le të mbesim kështu; frikësohem se me shoqërim zbulohen gabimet tona, e humbet dashuria ndaj njëri-tjetrit.”

Me këtë, Hasan Basriu na tregon për një tjetër dobi të vetmisë, e që është mos-zbulimi i personalitetit, ahlakut dhe gabimeve tona.

Duke lavdëruar ata që fshehën gjendjet e veta, Allahu Teala thotë:

“...prandaj ai që nuk e di gjendjen e tyre mendon se ata janë të pasur.” 2-Bekare: 273

Edhe poeti ka thënë:

***Nuk është turpi në varfëri,
Turp është kur rri në poshtërsi.***

Njeriu nuk mund të shpëtojë pa gabime në punët e fesë, dynjasë dhe ahlakut. Më mirë është që gabimet e fesë dhe të dynjasë të jenë të fshehta.

E kur personi hyn mes njerëzve, gabimet zbulohen, dhe nuk arrin në selamet.

Ebu Derda r.a., ka thënë:

“Përpara, njerëzit ishin trëndafil pa gjemb, tani janë bërë gjemb pa trëndafil.”

Nëse gjendja ishte e tillë në kohën pas shekullit të parë, ashiqare që sot është edhe më keq.

Sufjan b. Ujejn tregon:

“E kam njohur Sufjan Sevrin gjersa ishte gjallë e i fortë, e pasi vdiq, në ëndërr më tha:

- Pakëso të njohurit, sepse shpëtimi prej tyre më pas është i vështirë. Aspak nuk dyshoj se të gjitha të këqijat i përjetova nga shokët."

Njëri tregonte:

"Shkova të vizitoj Malik b. Dinar. Ishte ulur i vetëm, e një qen e kishte vënë kokën në këmbën e tij. Desha ta largoj qenin, e ai më tha:

- Lëje, ai nuk kafshon e as nuk bën dëm. Ai është më mirë se një mik i keq."

E pytën dikë pse është tërhequr në vetmi, e ai tha:

- U frikësova se do ta humbi fenë, pa e vërejtur.

Pikërisht! Sepse natyra e njeriut i përvetëson veset e këqija.

Ebu Derda r.a, ka thënë:

"Keni frikë Allahun dhe ruajuni nga njerëzit. Ata e lëndojnë deven që e ngarkojnë, edhe kalin që e shalojnë, e edhe zemrën ku hyjnë."

E dikush tjetër ka thënë:

"Pakëso të njohurit e tu, sepse selameti i zemrës dhe fesë është i mundur me pakësimin e shokëve dhe me pakësimin e të drejtave të tyre ndaj teje."

Nëse shumohen shokët, shumohen edhe detyrat ndaj tyre dhe bëhet e vështirë t'ju jepet haku të gjithëve. E një tjetër ka thënë:

“Braktisi të njohurit që ke, dhe mos shto njohuri të reja.”

DOBIA E PESTË

Dobia e pestë e vetmisë është këputja e shpresës tënde prej njerëzve, e edhe e tyre prej teje.

Në këputjen e shpresës së njerëzëve prej teje ka disa dobi.

Gjithashtu, vështirë është të kënaqet secili, prandaj angazhimi në përmirësimin e mangësive të veta është më i mirë.

Disa nga obligimet më të lehta janë përgjigja thirrjeve në dasmat dhe zifafetet e tyre, pjesëmarrje në ceremonitë e varrimit dhe vizita të sëmurit.

Përpos harxhimit të kohës, në të gjitha këto ka edhe ndeshje me rreziqe. Pastaj, përgjigja në disa ftesa sjellë akuzat për mos-përgjigje në ftesat tjera, e kjo bëhet sepse për zemërim dhe armiqësi.

Është thënë:

“Ai që nuk viziton të sëmurin në kohë të sëmundjes, kur i sëmuri shërohet, nga turpi kërkon vdekjen e tij. Por, ai që nuk viziton askë, atij nuk i thonë asgjë.”

Nëse personi zgjedh, atëherë atij i zemërohen. Por një njeri, edhe po të mundohet ditë e natë, nuk mund të përmbushë obligimet e të gjithëve.

Si mund t'i përmbush plotësisht të gjitha këto obligime ai që është i zënë edhe me çështjet e fesë edhe të dynjasë?

Amr b. As r.a., ka thënë:

“Shumë shokë, do të thotë shumë harxhime.”

Edhe Ibn Rumi ka thënë:

*“Mos bëj shumë shokë, kjo lind armiqësi,
e as mos ha shumë, kjo lind vështirësi.”*

Imam Shafiu ka thënë:

“Rrënja e gjithë armiqësive është miqësia me të këqijtë dhe mirëbërja atyre.”

Edhe në ndërprerjen e shpresës tënde prej njerëzëve ka dobi të mëdha.

Personi që sheh pasurinë e botës dhe stolisjen e saj, anon ka ajo, e dëshiron atë dhe i shtohet pangopësia. Në të shumtën e rasteve, kur nuk arrin atë që dëshiron, e humb shpresën dhe brengoset. Por nëse nuk përzihet me njerëzit, këto as nuk i sheh. E kur nuk i sheh, as nuk i dëshiron, dhe jeton në rehati. Për këtë arsye, Allahu Teala thotë:

“Mos e hidh shikimin në të mirat kalimtare...”

20-Ta Ha: 131

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Drejtojeni shikimin nga ata që janë ndër ju dhe jo ata që janë mbi ju. Kjo është më e mirë, që të mos nënvlerësoni ndihmën dhe mirësinë që u është dhuruar nga Allahu Teala.”⁴²

Avn ibn Abdullah ka thënë: *“Jam shoqëruar me të pasurit, e përherë isha disi i dëshpëruar. Kam parë sesi rrobat e tyre janë më të mira sesa ato të miat, sesi kuajt e tyre ishin me te fortë sesa kali im. Fillova më pas të shoqërohem me të varfërit, dhe arrita qetësinë.”* Tregohet se Muzeni (Allahu e mëshiroftë), duke dalë prej xhamisë në Fustat⁴³, i doli përballë Abdulhakemi duke kalëruar. Pamja e tij madhështore e hutoi, dhe filloi te lexojë ajetin:

“...Ne bëmë njërin prej jush sprovë për tjetrin se a do të jeni të durueshëm...” 25- Furkan: 20, e më pas tha: *“Unë bëj sabër dhe jam i kënaqur”*, e përndryshe ishte njeri i varfër.

Ai që rri në shtëpi nuk do të infektohet në intriga të tilla. E ai që mahnitet nga stolitë e kësaj bote - ose duhet të bëj sabër për shkak të fesë dhe bindjes së patundur, e që në këtë situatë do t'a shijojë shijen e idhët të sabrit, ose do t'i ndizet malli për dynja dhe për ta përfituar dynjallëkun hyn në rrugë të mashtrimit dhe shkatërrohet përgjithmonë.

⁴² Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

⁴³ Fustat - rajon i Kairos

Shkatërimi në dynja zakonisht ndodhë sepse dëshirat dhe ambiciet janë të parealizueshme, ndërsa shkatërimi në ahiret është për shkak të preferimit të pasurive të kësaj bote mbi përkujtimin (dhikrin) e Allahut Teala dhe afrimit Atij. Andaj Ibn Arabi ka thënë:

***Kur dera e poshtërimin hapet kah pasuria,
unë e braktis e ngritem në nder, kah varfëria.***

Me këtë ka treguar se si dëshira ndaj kësaj bote shkakton poshtërim.

DOBIA E GJASHTË

Dobia e gjashtë është shpëtimi nga zullumqarët dhe nga njerëzit budallenjë; nga durimi i budallakive dhe sjelljeve të tyre të palakmueshme. Orientimi nga njerezit e tillë është një verbëri e vogël. E kanë pyetur Ameshin:

- *Përsëtë loton syri?, e Ameshi u përgjigj:*
- *Më loton nga shikimi i budallenjëve.*

Tregohet se si njëherë Ebu Hanife shkoi te Ameshi, dhe i tha:

- *Në hadith qëndron se atij që i humb shikimi, Allahu Teala e shpërblen me diçka më të mirë. Me çka të ka shpërblyer ty?"* Ameshi tha:

- *Më ka shpërblyer me shpëtim nga shikimi i njerëzve zullumqarë. Pastaj, si në shaka i tha:*

- *E një ndër ta je edhe ti.*

Ibn Sirini tregon:

- *Kam dëgjuar një njeri të thotë: “E drejtova shikimin nga një njeri zullumqar njëherë, dhe menjëherë e humba vëtedijen.”*

Galenus (filozof Grek)ka thënë: *“Gjithcka ka ethet e veta. E ethetë shpirtit janë shikimet e drejtuara atyre që japin shqetësim.”*

Ndërsa Shafiu, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: *“Kur jam mes njerëzve, anën e kthyer kah ai që s’më pëlqen e ndjejë si më të rëndë.”*

Të gjitha këto dobi, përveç dy të parave, kanë të bëjnë me qëllimet e përditshme të kësaj bote por janë të ndërlidhura edhe me besimin. Edhe nëse njeriu arrint’i ikë shikimit të atij që s’e pëlqen, ai nuk do të mund të mbrohet nga përfolja dhe as urrejtja mbi atë që Allahu Teala e ka krijuar. E nëse përfolja, mendimet e palakmueshme, zilia, shpifja dhe te ngjashme vijnë nga të tjerët, ky nuk do të mund t’i përmbahet reagimit të ashpër.

E gjithë kjo e dobëson besimin, ndërsa shpëtimi nga të gjitha këto është vetëm në vetmi, kjo le të dihet!

DOBITË E SHOQËRIMIT DHE DËMET E VETMISË

Duhet ta dish se ka shumë dobi, edhe të dynjasë e edhe të fesë, që arrihen përmes ndihmës së të tjerëve. E kjo ndihmë arrihet me pjesëmarrje në shoqëri. Gjithçka që mund të arrihet përmes shoqërimit me njerëz, nuk mund të arrihet në uzlet (vetmi). Pra, privimi nga kjo dobi, është dëm i shkaktuar nga vetmia. Prandaj mendo dobitë e shoqërimit, dhe arsyet që e tërheqin njeriun në të.

Këto arsye mund të jenë përfitimi i diturisë, mësimdhënia, përfitimi material dhe shpirtëror, miqësia e afërsia, fitimi i sevapeve, si edhe nxjerrja e mësimi nga vrojtimi i gjendjeve të njerëzve.

Të gjithë këtë duhet t'a studiojmë gjerë e gjatë. Bëhet fjalë për dobitë e shoqërimit me njerëz, e në përgjithësi janë shtatë:

DOBIA E PARË

Dobia e parë është përfitimi i diturisë dhe mësimdhënia. Dobinë e tyre tashmë e kemi përmendur në *Librin për Diturinë*, e të dyja janë ibadetet më të mëdha në këtë botë, qe ë as nuk mund të paramendohen të arrihen pa shoqërimin me njerëz. Megjithatë dituritë janë të shumta. Disa mund të anashkalohen ndërsa të tjerat janë të

domosdoshme për këtë botë. Atij të cilit dituria i është e nevojshme dhe e obligueshme ta përfitojë, e ka gabim nëse vendos që të tërhiqet në vetmi. Nëse e mëson farzin dhe përmes farzit thellohet në shtigje më të thella të diturisë, duke menduar se më mirë është t'i përkushtohet ibadetit, atëherë le të tërhiqet në vetmi! Por nëse është i aftëtë thellohet në diturinë e sheriatit dhe dituritë tjera racionale, e pa i mësuar këto tërhiqet në vetmi, do të ishte dëm i madh për të. Për atë arsye Ibrahim Nehai dhe të tjerët kanë thënë: *“Bëhu i ditur, e më pas tërhiq në vetmi!”*. Ai që vetmohet para se të bëhet i ditur, në shumicën e rasteve e kalon kohën në gjumë apo duke menduar për gjëra të kota.

Më së shumti se çfarë mund të arrijë është të kalojë kohën duke bërë dhikër aq sa ka mundësi. Mirëpo, as ibadetet trupore e as ato të zemrës nuk do të jenë të kursyera nga provokimet e ndryshme të cilat vetëm se do të shkaktojnë mundim, e që ai as mos ta ndjejë se po ndodhë diçka e tillë. As besimi i tij në Allahun Teala, në cilësitë e Tij dhe në mirësitë e Tij nuk do të jenë të mbrojtura nga imagjinata që do e ngarkojë dhe as nga mendimet e këqija që do ta kaplojnë. Andaj në shumicën e rasteve ai bëhet lodër e shejtanit, ani pse veten akoma e konsideron besimtar të denjë.

Dituria është themeli i besimit. Nuk ka dobi në vetmi për njerëz të rëndomtë dhe për ata që nuk dinë se si të veprojnë në izolim (*halvet*), dhe që nuk e njohin përmbajtjen e vetmisë. Nefsi i njeriut është sikur i sëmuri që ka nevojë për një mjek të mëshirshëm që ta shërojë. Siç mund t'i shtohet sëmundja xhahilit të sëmurë nëse nuk i mëson dituritë e mjekësisë, as xhahili në fe nuk mund të tërhiqet në vetmi pa i mësuar dituritë e nevojshme. Andaj vetëm dijetarët meritojnë vetminë.

E nëse nijeti i studiuesit është rizaja e Allahut, atëherë ai ka shpërblim të madh. Por nëse nijet është dynjallëku, atëherë në një gjë të tillë gjindet fundi i besimit. Për këtë kemi biseduar në *Librin për Dituri*.

Dijetarët e kohës tonë i japin përparësi tërheqjes në vetmi, sepse në këtë kohë ka shumë pak të tillë që dëshirojnë të marrin dituri për selametin e fesë. Njerëzit sot mësojnë fjalë të bukura dhe shprehje materialiste, që t'i përdorin në vaz për të tërhequr popullin dhe për të hyrë në debat që t'i heshtin rivalët, e me qëllim që t'i afrohen pushtetit. Dituria më e vlefshme që dëshiron të mësojë është rruga (medh'hebi) i vet. Kjo shpesh nuk bartë nijet të sinqertë sepse nijeti zakonisht është të posedojë më shumë dituri se sa të tjerët, për të fituar post dhe për t'u pasuruar. Feja dhe mendja e shëndoshë urdhërojnë largimin nga persona të tillë. E nëse

gjindet një nxësës që synon rizanë e Allahut, largimi dhe fshehja e diturisë prej tij është gjynah i madh. Njerëz të tillë jashtëzakonisht vështirë gjinden, e edhe nëse gjinden, janë vetëm një a dy në secilin rajon.

Të mos na mashtrojnë fjalët e Sufjan Serviu, kur thotë: *“Ne mësuam diturinë për qëllime tjera, por dituria nuk pranoi të jetë për tjetër qëllim përveç për Allahun.”*

Pra, fakihët në filim mësojnë dituri për qëllime tjera, e pastaj dituria ua përmirëson qëllimin dhe i kthen Allahut. Shih se si ishte fundi i jetës për shumicën prej tyre, dhe nga ajo nxjerr mësim! E të dëgjohet nuk është njësoj sikur te shihet. Disa vdiqën duke ngarendur pas kësaj bote, e disa ia kthyen fytyrën kësaj bote dhe iu drejtuan ahiretit.

Dije se dituria të cilës i referohet Sufjani është dituri e hadithit, tefsirit dhe jetës së Pejgamberëve. Në këto dituri ka frikësim për njerëz, dhe ato, herët a vonë e shtojnë frikën ndaj Allahut Teala.

Sa i përket personit që ngarend pas kelamit dhe fikhut lidhur me fetvanë tek marrëdhëniet ndërnyerëzore dhe mosmarrëveshjet brenda medh’hebit, ai e dëshiron këtë botë dhe gradualisht, kjo dëshirë vetëm i shtohet.

Shpresa është se, ndonjë nxënës që e dëshiron këtë botë, në saje të leximit të këtyre shkrimeve, e përmirëson veten kah fundi i jetës. Sepse këto libra janë përplot këshilla për frikësim prej Allahut, largim prej kësaj bote e afrim ahiretit. Këto gjinden në Kur'an dhe hadithe, por jo në dituri të kelamit, filozofisë dhe medh'hebit. Andaj nuk është e drejtë që njeriu ta mashtrojë veten. Ai që i di mangësitë e veta është më i lumtur se sa xhahili i mashtruar.

Çdo dijetar që ka elan për të mesuar të tjerët është i ekspozuar rrezikut që qëllim i tij të jetë pozita dhe posti. Për të tillët, dituria përbën një kënaqësi të përkohshme lavdërimi dhe mendjemadhësie karshi xhahilëve. Siç ka thënë Resalallahu s.a.v.s.:

“Shkatërrimi i diturisë është (pikërisht) mendjemadhësia.”

Tregohet se Bishr Hafiu i ka groposur shtatëmbëdhjetë bohçe me libra të haditheve që i ka dëgjuar e kurrë nuk i ka transmetuar. Atyre që e pyetën për arsyen e mos-transmetimit, ju përgjigj:

“Nefsi dëshiron të flasë e transmetojë, nëse e mposhti nefsin, atëherë do të flasë.”

Pra, nuk i ka transmetuar për të mos iu përshtatur dëshirës së nefsit. Për këtë ka thënë: *“Neve na u transmetua hadithi”*; domethënë (vet transmetimi) është një derë e dynjallëkut. Kur dikush

thotë: *“Na u transmetua hadithi”*, me gjuhën e gjendjes thotë: *“U çel një derë e fitimit për mua”*, dhe me atë transmetim mundohet të sigurojë ndonjë pozitë për vete.

Rabia el-Adavija i tha Sefjan Sevriut:

- *Sa njeri i mirë që je! Vetëm të mos e kishe dëshirën e dynjallëkut! Sufjani e pyeti:*

- *E çfarë dëshire kam unë?* Rabia i tha:

- *Po transmeton hadithe.*

Edhe Ebu Sulejman ed-Darani ka thënë:

“Kush martohet, kërkon hadith apo gjen argëtim në udhëtim, ai llogaritet që dëshiron dynjallëkun.”

Të gjitha këto bela i kemi shpjeguar hollësisht në *Librin për Diturinë*. Mençuri është t'i ruhemi kësaj përmes vetmisë, dhe nëse është e mundur, të kemi sa më pak miq. Ata që në dituri angazhohen me qëllim të fitimit të dynjallëkut, më mirë e kanë që me kohë të largohen nga kjo, nëse janë të mençur. Të vërtetën e ka thënë Sulejman Hattabi:

“Kaloi ata që dëshirojnë të bëjnë bisedë me ty dhe të mësojnë nga ti. Nga ta nuk ke asnjë dobi. Ata janë miq në dukje të jashtme, e në fshehtësi janë armiq. Kur të takojnë sillen mirë me ty, e kur largohen të përqeshin. Kush të vie nga ata, të lavdojnë, e kur largohen - gjuha e tyre vepron kundër teje. Ata janë njerëz dyfyturësh, ngatërrestarë, të pandershëm dhe hileqarë. Mos të mashtrojë numri i madh i atyre që

mbledhen e kërkojnë dituri prej teje. Qëllimi i tyre nuk është dituria, por pozita dhe pasuria. Për ta je vetëm një mjet përmes të cilit i realizojnë qëllimet dhe synimet e tyre, hamall për nevojat e tyre. Nëse refuzon cilëndo kërkesë të tyre, ju bëhesh armiku më i madh. Më pas të sulmojnë duke i përmendur ‘gjitha të mirat’ që i kanë bërë ndaj teje si dëshmi kundër teje. Të detyrojnë t’i përshtatesh pamjes se tyre, këndvështrimeve dhe besimit të tyre, të bëhesh armik i armiqtve të tyre, t’u ndihmosh miqtve dhe shërbëtorëve të tyre. Me një fjalë të bëhesh budalla, ndërsa ishe i menqur. Të jesh i udhëhequr nga ta verbërisht, pasi ishe vet udhëheqës. Andaj edhe thuhet: vetmia është bujari.”

Pra, ky është kuptimi i porosisë së Ebu Sulejmanit. Sado që shkruesi i këtyre radhëve ka edhe disa fjalë që nuk i ka thënë, drejtë ka folur.

Sepse ju e shihni se si mësuesit (*myderriz*) janë të ngarkuar me obligime ndaj nxënësve. Thuaj se myderrizët janë të obliguar t’ju japin dhurata vizitorëve! Edhe nxënësit presin nga myderrizët të sillen sikur të ishin borxhli të tyre. Me siguri ata as nuk do t’i vizitonin po të mos e kishin punën dhe aq ngushtë.

E mësuesit e varfër, që nuk janë në gjendje të japin nga pronësia e tyre, i vizitojnë udhëheqësit dhe i durojnë përuljet duke pranuar edhe dhurata që nuk

janë hallall, vetëm për të mbijetuar nxënësit- një ditë, një javë një muaj. Më pas përballet me ndarjen e asaj që ka mbledhur: Nëse ndanë në mënyrë të barabartë mes nxënësve, të rriturit do ta urrejnë e do ta shpallin budalla të papërmirësueshëm, të paaftë për të vënë drejtësi. Nëse nuk ndanë në mënyrë të barabartë, do ta sulmojnë të tjerët, sikur të ishin bisha.

Shkurt, myderrizi gjithë jetën është në vështirësi nga ata, e në ahiret do të japë llogari për atë që ka marrë dhe si e ka ndarë.

E çudi se si ai, përkundër gjithë kësaj, e mashtron veten:

“Mos iu largo çasjes tënde! Ti vetëm po kërkon rizanë e Allahut Teala, po përhapë sunnetin e Resulallahut s.a.v.s., dhe diturinë mbi besimin. Je duke i siguruar kushtet e domosdoshme për nxënësit. Çka është më e rëndësishme se përhapja e diturisë? Me myderrizë të tillë feja lulëzon e forcohet!”

Po të mos ishte ky mësues lodër në duart e shejtanit, do ta kishte kuptuar më lehtë se mësuesit e tillë, që hanë atë që e shohin pa e ndarë prej haramit, bëhen shkas për gjendjen e keqe, e xhahilët duke i shikuar ata, marrin guximin dhe dalldisen në haram. Andaj edhe thuhet:

“Asnjëherë populli nuk ka devijuar para se të devijojnë udhëheqësit, e udhëheqësit nuk devijojnë, para se të devijojnë dijetarët.”

Allahut Teala i kërkojmë mbrojtje nga mashtrimi e verbërimi! Ky është helm që nuk ka ilaç.

DOBIA E DYTË

Dobia e dytë në shoqëri me njerëz është përfitimi i personit dhe të tjerëve. Personi fiton përmes angazhimit të përbashkët, e kjo nuk arrihet pa pasur kontakt me njerëz. Ai që e ka një nevojë të tillë, do të duhej të largohet nga vetmia. Në këtë rast, nëse dëshiron të sigurojë fitim të ligjshëm (sipas shariatit), përballet me shumë vështirësi. Ndërsa këtë e kemi shpjeguar në *Librin për Pasurinë*.

Nëse do të kishte pasuri aq sa i është e nevojshme, kurse deri tek pasuria shtesë do të arrihej vetëm përmes haramit, atëherë vetmia do të ishte më e mirë për të. Angazhimi i tij për të fituar pasuri shtesë është i pranueshëm vetëm nëse e ka nijet që të japë ndihmë (*sadaka*) nga pasuria. Por, nëse nijet i tij është që në vetmi të arrijë hakikatin hyjnor, të arrijë në thelbin e diturive të shariatit duke menduar dhe përmes dhikrit, dhe t'i drejtohet me tërë ekzistencën Allahut Teala, atëherë një nijet i tillë

është mëi vlefshëm se sa nijeti për sadaka. Me këtë mendoj në ata që këtë e kanë arritur përmes keshf-it dhe basiretit, e jo përmes imagjinatës së kotë.

Sa i përket përfitimit të tjerëve, ky u ofron ndihmë atyre që kanë nevojë, me vepër ose me pasuri. Në ndihmën vëllait mysliman për rizanë e Allahut ka sevap, e ky shpërblim arrihet vetëm me pjesëmarrje në shoqëri. Ai që ka mundësi të veprojë kështu e në të njëjtën kohë qëndron në kornizat e shariatit, atëherë kjo është më e mirë për të sesa vetmia, sidomos nëse në vetmi do të praktikonte vetëm namazin nafile. Por, nëse është prej atyre që Allahu Teala u jep *basiret* – ua hapë zemrën për të kuptuar hakikatin, dhe nëse vazhdon me zemër dhikrin dhe mendimin, atëherë kjo nuk krahasohet me asgjë!

DOBIA E TRETË

Dobia e tretë është edukimi i të tjerëve dhe vetes, ku me këtë të dytën mendohet në durimin që duhet të kemi ndaj njerëzve. Duke duruar vështirësitë që vijnë nga njerëzit, ai lufton me nefsin, dhe kështu përfiton. Këto janë dobi që arrihen në shoqërim me njerëz, e për atë që nuk e ka përmirësuar ahlakun dhe që kënaqësitë nuk iu kanë kufizuar në bazë të rregullave të shariatit, kjo dobi është më e vlefshme se sa vetmia.

Për këtë arsye hyzmetqarët e sufijve kanë preferuar teqet për hyzmet; shkonin në çarshi dhe kërkonin ndihmë për teqe, e të gjitha këto i kanë bërë me qëllim për të mposhtur nefsin dhe për të përfituar nga duatë e sufive. Pra, ky ishte qëllimi në kohët e shkuara.

Ndërsa sot, e gjithë kjo është e përzier me qëllime të prishura dhe është e larguar nga normat e vërteta, njëjtë siç ka ndodhur edhe me veçoritë e tjera te besimit. Sot me hyzmet synohet numri më i madh i pasuesve dhe pasuria. Nëse ky është nijeti nga shoqërimi me njerëz, atëherë vetmia është më e mirë, qoftë edhe tërë jetën. Mirëpo, nëse nijeti është edukimi i nefsit, atëherë shoqërimi me njerëz për atë që ka nevojë për edukim është më i mirë sesa vetmia. Kjo sepse ai në fillim ka nevojë për këtë, e në fund të edukimit shpirtëror duhet ta dijë se qëllimi i edukimit të kalit nuk është vet edukimi por kalërimi i kalit të edukuar, për të kaluar rrugën. E trupi është bartësi i zemrës që ecën në rrugë të ahiretit. Nëse nuk i mposhtë epshtet, trupi bën kryengritje gjatë rrugës.

Ai që ia kushton gjithë jetën këtij lloji të edukimit është sikur ai që gjithë jetën ia kushton edukimit të kalit për edukim, por asnjëherë nuk e kalëron.

Nga edukimi nuk ka dobi nëse kali vetëm nuk kafshon dhe nuk shkelmon. A është kjo dobia që synohet të arrihet?! Një dobi e tillë mund të gjindet edhe tek kali i ngordhur, as nuk kafshon e as nuk shkelmon. Por kali është i nevojshëm për shkak të dobisë që e ofron derisa është gjallë.

Njëjtë me largimin nga joshjet dhe kënaqësitë kur jemi në gjumë apo të vdekur. Me këtë nuk duhet të mjaftohemi! Sikur murgu që e kanë thirrë: “O murg!”, në çka ai u përgjigj: “Nuk jam murg. Jam vetëm një qen sulmues. E nefsën e kam mbyllur në kafaz, që të mos kafshojë njerëz.”

Kjo është e bukur, kur dihet që njerëzit nuk kafshojnë. Mirëpo nuk duhet të kufizohemi vetëm në këtë; as i vdekuri nuk i kafshon njerëzit.

Ai duhet të ngritet deri në atë masë që edhe kërkohet. Ai që e kupton këtë e gjen rrugën e drejtë, dhe nëse i mjafton fuqia për *suluk* (edukim shpirtëror), do ta ketë të qartë se vetmia është më e mirë për të. Për njeriun e tillë në fillim më i mirë është shoqërimi me njerëz, e më pas vetmia.

Pra një dobi nga shoqërimi më njerëz është vet-edukimi për të sunduar nefsën.

Sa i përket edukimit të tjetrit, kjo nënkupton edukimin e personit që të vetëkontrollojë nefsën, e kjo është gjendja dhe veprimi i shejhut karshi sufiut:

Shejhu mund ti edukojë sufitë vetëm nëse është me ta. Ai është edukator dhe mësues. Por, edhe këtu ekziston hapësira për gabime, si hipokrizia (*rija*) dhe vese të ngjashme që ndodhin gjatë edukimit.

Por, sufiu që ndjekë edukimin e nefsit ëndërron më pak për këtë botë se sa ai që kërkon dituri. Andaj, në këtë çështje ai duhet të kontrollojë gjendjen e vet. Nëse dëshiron të jetë i dobishëm për njerëzit, atëherë duhet të shoqërohet me ta, e nëse nuk sjell dobi, atëherë duhet të preferojë vetminë. Kjo kuptohet me një analizë të hollësishme, dhe ndryshon sipas personit. Nuk mund të gjykohet në mënyrë absolute se a është më e mirë vetmia apo shoqërimi me njerëz.

DOBIA E KATËRT

Dobia e katërt është miqësia dhe afërsia. Ky është qëllimi i atyre që vizitojnë të tjerët, shkojnë në dasma, pranojnë ftesat dhe shkojnë në vendet ku shoqërohen dhe afrohen më të tjerët. Kjo gjendje në një moment i ngjallë edhe dëshirat enefsit. Shoqërimi me njerëz të këqij mund të jetë haram, por mund të jetë edhe mubah, bile mund të jetë edhe e preferuar (*mustehab*) në disa raste, për shembull kur personi e bashkendjenë tjetrin derisa i qan hallet me të, apo kur ndajnë mendime lidhur me

besimin, apo edhe përmes afërsisë me shejhun, tek i cili e ndjenë rrugën e devotshmërisë. Kjo afërsi, nganjëherë vjen prej dëshirës së nefsit, e megjithatë do të jetë *mustehab*, nëse nijeti është që t'i sjellë rehati zemrës përmes ibadetit. Nëse zemra është e detyruar të bëjë diçka kundër dëshirës, ajo verbohet. Kur nuk gjen rehati në vetmi, por në shoqërim me njerëz, shoqërimi është më i mirë. Sepse maturia në ibadet lind nga dëshira dhe kërkesa e zemrës. Për këtë, Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Allahu Teala nuk e ndërpre në shpërblimin përderisa ju nuk dembeloseni në ibadet.”⁴⁴

Askush nuk mund të shpëtojë nga kjo gjendje, sepse nefsi nuk mund të jetë vazhdimisht i lidhur me Hakkun, dhe kërkon të pushojë kohë pas kohe, me gjëra tjera. Nëse nefsi detyrohet vazhdimisht në ibadet, ai dembeloset. Ky është edhe qëllimi i Resulallahut s.a.v.s., kur thotë:

“Kjo fe është e fuqishme, prandaj thellohu në të me butësi!”⁴⁵

Thellimi në të me butësi është veti e njerëzve mendjemprehtë. Prandaj dhe Ibn Abbasi ka thënë:

“Po të mos e kisha frikën nga vesvesja, nuk do të shoqërohesh fare me njerëz.”

⁴⁴ Hadithi tashmë është përmendur.

⁴⁵ Hadithi tashmë është përmendur.

E gjithashtu ka thënë:

“Unë shkoj atje ku nuk është askush.”

Andaj ai që tërhiqet në vetmi, ka nevojë për dikë me të cilin do të bisedojë, së paku një orë në ditë. Le te gjejë një shok që me atë orë nuk ia prishë kohën tjetër.

Sepse Resulallahu a.s. thotë:

“Njeriu është në fenë dhe ahlakun e shokut të tij, prandaj keni shumë kujdes kë po e zgjidhni për shok.”⁴⁶

Le të ketë kujdes që në kohën kur takohet me shokun, biseda e tyre të jetë për besimin ose për gjendjet e zemrës, apo për mangësitë në qëndrueshmëri në të vërtetën dhe për mos-pasimine rrugës së drejtë.

Pra, bisedat si kjo japin pushim dhe qetësi për zemrën. Për ata që punojnë në përmirësimin e nefsit këtu ka mundësi të gjerë, sepse ankesat në këtë çështje nuk ndalen, edhe nëse jetohet shumë gjatë. Ai që është i kënaqur me nefsin e tij, padyshim është i devijuar.

Pra, për disa, biseda me një shok besnik në orë të caktuar të ditës, është më e mirë sesa vetmia. Por, njeriu duhet së pari të studiojë gjendjen e zemrës së vet dhe gjendjen e atij me të cilin dëshiron të shoqërohet, e tek më pas të ulet me të.

⁴⁶ Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Hakimi, nga Ebu Hurejre r.a.

DOBIA E PESTË

Dobia e pestë është fitimi i sevapit dhe mundësimi të tjerëve që të fitojnë sevape. E fitimi i sevapit nga shoqërimi me njerëz arrihet nëse u shkojmë të tjerëve në ceremoni të varrimit, me vizitë të sëmurit, vizitë për Fitër e Kurban Bajram, në namazin e xhumasë që është farz, dhe poashtu përmes faljes së namazeve tjera me xhemat. Nuk i lejohet të braktisë namazet me xhemat. Mosfalja e namazit me xhemat arsyetohet vetëm nëse ekziston një frikë e arsyeshme apo në rast të ndonjë fatkeqësie. Por, një gjë e tillë ndodhë shumë rrallë. Sevap të njejtë ka në pjesëmarrjen në dasma dhe ngjarje të ngjashme, pasi që ngjarjet e tilla ndjellin lumturi në zemrën e myslimanit.

Sa i përket mundësisë që të tjerët të fitojnë sevape, le të hapë vetëm derën e vet që të tjerët ta vizitojnë, në ditë të lumtura, kur sëmuret, për ngushëllim, ta ndihmojnë në vështirësi dhe t'ia lehtësojnë me mirëqenie. Me këtë do të fitohet sevapi. Njësoj është edhe nëse bëhet i pari që ua lejon ta vizitojnë, ata do të kenë sevape nga ajo vizitë ndërsa ai do të jetë arsyeja që ua ka mundësuar një gjë të tillë.

Prandaj duhet të peshohen sevapet që arrihen përmes shoqërimit me njerëz me dëmet që i kemi përmendur. Kur të veprojmë kështu, ndonjëherë do të peshojmë më shumë vetmia e ndonjëherë shoqërimi me njerëz. Imam Maliku dhe të ngjashëm disa person, transmetohet se si nuk i kanë pranuar ftesat, bile nuk kanë vizituar të sëmurit dhe as që kanë marrë pjesë në xhenaze, por kanë qëndruar në shtëpi. Dilnin vetëm për namazin e xhumasë dhe për t'i vizituar varrezat. Disa prej tyre madje kanë lëshuar edhe qytetin duke shkuar në vise malore, për t'iu përkushtuar ibadeteve dhe larguar nga telashet.

DOBIA E GJASHTË

Dobia e gjashtë është modestia, një ndër virtytet më me vlerë, e që nuk mund të arrihet në vetmi. Ndonjëherë mendjemadhësia bëhet sepse për tërheqje në vetmi.

Në njërin nga tregimet e hebrenjëve transmetohet se si një i urtë ka shkruar 360 libra mbi urtësinë, dhe ka menduar se si përmes një akti të tillë ka arritur të sigurojë një vend të veçantë pranë Allahut Teala. Allahu Teala e lajmëroi Pejgamberin e asaj kohe që t'i thotë të urtit:

“E ke mbushur tokën me dyfytësinë tënde! Nuk pranoj asgjë nga kjo!”

Ai u tërhoq në vetmi në një shpellë dhe tha:“*Eh tash kam arritur kënaqësinë e Allahut Teala*”. Prapë, Allahu Teala i shpalli Pejgamberit që t’i thotë:

“Thuaji atij njeriu se nuk do të arrijë kënaqësinë Time derisa nuk shoqërohet me njerëz dhe nuk tregohet i durueshëm ndaj mundimeve që ata ia shkaktojnë.”

Ashtu edhe ndodhi. Ai filloi të dalë nëpër tregje e qendra të qytetit dhe të kontaktojë me njerëz, të shoqërohet me ta, filloi të ushqehet në mesin e tyre dhe të shëtisë tregjet me ta. Pas kësaj, Allahu Teala i shpalli Pejgamberit që t’i thotë:

“Tani e ke arritur kënaqësinë Time!”

Ka shumë njerëz që preferojnë vetminë nga mendjemadhësia, për shkak që nuk mund të arrijnë respekt prej njerëzve dhe nuk u jepet ndonjë pozitë, e këta mendojnë se duke preferuar vetminë, do të përfitojnë respektin e njerëzve dhe gradë më të lartë.

Ndonjëherë, personi tërhiqet në vetmi për të mbuluar mangësitë e veta, duke e paraqitur veten asket karshi njerëzëve, e qëllim nuk e ka namazin, dhikrin dhe meditimin. Shenjë identifikuese e tyre është se ata kanë dëshirë të vizitohen, e të mos vizitohen. Gëzohen kur njerëzit u vinë te pragu, kur mblidhen rreth tyre e ua puthin duart. Nëse një

person i tillë me të vërtetë do të përpiqej të edukojë nefsën e vet, ai nuk do ta shihte të shëmtuar shoqërimin me njerëz dhe vizitat, e gjithashtu nuk do t'i pëlqente të vizitohet.

E kemi treguar më parë këtë situatë me shembullin nga Fudajl b. Ijaz, kur i tha atij që e vizitoi:

“Ti më erdhe në vizitë i pispillosur, edhe unë duhet të pispillosem për ty.”

Edhe kur një vali e vizitoi Hatemi Esammin, e i tha:

- *Nëse keni nevojë për diçka, më trego dhe menjëherë e zbatojmë*, e Hatemi i tha:

- *Po kam, zbatoje menjëherë: as ti nuk do të më shohësh më, as unë ty, as ti nuk më njeh, e as unë ty.*

Ai i cili në vetmi nuk angazhohet me dhikër dhe meditim, qëllimi i tij nga vetmia është të përfitojë respektin e njerëzëve. E tërheqja në vetmi për këtë qëllim është padituri (*xhahiliet*) nga disa pikëpamje:

1. Modestia dhe shoqërimi me njerëz nuk ulë pozitën dhe vlerën e diturisë së personit, siç ka thënë Hz. Aliar.a., duke bartur ushqim për në shtëpi:

“Nuk i dëmtohet përsosshmëria atij që bartë ushqim për familjen.”

Ebu Hurejre, Huzejfe dhe Ibn Mesudi r.a., bartnin dru dhe miell për në shtëpi, me shpinë. Ebu Hurerje r.a., edhe pse ishte emir i Medines, bartte dru mbi kokë për në shtëpi, e rrugës thoshte:

“Hapni rrugë për emirin tuaj!”

Vet Resulallahu s.a.v.s. blente gjëra dhe i bartte për në shtëpi. Njëherë, shoku pranë tij i tha:

“Mi jep mua, që ti dërgoj në shtëpi!”, e në atë Resulallahu s.a.v.s. tha:

“E drejta e pronarit është të bartë atë që është e tij.”⁴⁷

Një ditë, Hasan b. Alia r.a., kaloi mbi mushkë pranë disa lypsarëve, që kishin shtruar sofrën. Hasani r.a., u dha selam, ata e kthyen selamin, e i thanë:

“O i biri i vajzës së të Dërguarit, urdhëro e ha me neve.” Hasani r.a., zbriti nga mushka e hëngri bashkë me ta. Pastaj hipi në mushkë, u dha selam, dhe tha:

- Padyshim se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë.

2. Aspekti i dytë i paditurisë është ky: ai që është i zënë pas kënaqësive të dynjasë dhe i preokupuar që njerëzit të kenë mendim të mirë për të, është me të vërtetë i mashtruar. Nëse i tilli do ta kishte njohur me të vërtetë Allahun Teala, do ta dinte se nuk ka asnjë

⁴⁷Ebu Ja’la nga Ebu Hurejre r.a..

dobi nga njerëzit. Dëmi dhe dobia janë në fuqinë e Allahut Teala, e të askujt tjetër. Do ta duhej ta dinte ai që kërkon kënaqësinë (rizanë) e njerëzve përmes zemërimit të Allahut Teala, Allahu zemërohet me të dhe njerëzit që janë përreth tij i bën të ndjehen të zemëruar ndaj tij. Në fakt, kënaqësia e njerëzve është qëllim që nuk arrihet. Më e rëndësishme është të kërkohet kënaqësia e Allahut. Prandaj Imam Shafiu i ka thënë Junus ibn Abdul-A'la-ut:

“Vallahi unë vetëm mund t’ju këshilloj: dije se nuk ka shpëtim nga thashethemet e njerëzëve, se është e pamundur t’i bësh të lumtur të gjithë njerëzit. Prandaj mos shiko të tjerët, por shiko veten, dhe bëj atë që është e hairit për ty.”

E është thënë:

*Kush mendon të lumturojë të tjerët,
nuk shpëton nga derti,
E i guximshmi, arrin te selameti!*

Sehli Tusterii tha njërit prej nxënësve: *“Bëje kështu e ashtu”* për diçka që e kishte urdhëruar, e ky iu përgjigj: *“O Mësues, nuk mund ta bëj atë mes njerëzve! Sehli u kthye nga të tjerët, e tha:*

- Njeriu nuk arrin hakikatin derisa:

1) *Nuk mbështetet tek njerëzit, në dynja nuk sheh asgjë dhe askë përveç Krijuesit, dhe e di me bindje se askush nuk mund t'i bëj dëm e as t'i sjellë dobi, përveç Allahut Teala; dhe e dyta:*

2) *Të shpëtojë nga nefsi, e të jetë indiferent me atë se si e shohin të tjerët.”*

Imam Shafiu, Allahu e mëshiroftë, ka thënë:

“Secili ka edhe miq edhe armiq. Por ti largohu edhe nga miku edhe nga armiku, e bashkohu me ata që bëjnë ibadet.”

Njëherë i thanë Hasan Basriut: *“O Ebu Seid, njerëzit vijnë në mexhlisin tënd vetëm për t'i gjetur gabimet tua dhe që të ngarkojnë me pyetje!”* Ai buzeqeshi, dhe tha:

- Mos u shqetësoni !Unë e qetësoj veten me xhenetli dhe me miq të Allahut, e kurrë nuk kam shpresuar të gjej selamet prej njerëzve. Unë e di se as Krijuesi i tyre, që u jep frymë, i gjallëron dhe ua cakton jetën deri në momentin e vdekjes nuk është i kursyer nga gjuha e tyre, e kush janë unë.

Musa a.s., bëri dua:

- *O Allah, më mbroj nga gjuha e njerëzve!, e në këtë Allahu Tealai shpalli:*

- O Musa, këtë që nuk e kam bërë as për Vete, e si ta bëj për ty!

Allahu Teala i ka shpallur Uzejirit s.a.:

“O Uzejir! Unë nuk të llogaris ty modest, nëse nuk je i kënaqur me ata që Unë i urdhëroj të të kritikojnë.”

Andaj, ai i cili vetmohet në shtëpi në mënyrë që të tjerët të kenë mendim dhe fjalë të mira për të, ai është në hall.

“...por dënimi i botës tjetër është edhe më i madh, sikur ta dinin ata.” 39– Zumer: 26

Sipas kësaj, vetmia është e preferuar vetëm për atë që kohën ia kushton dhikrit, meditimit, ibadeteve dhe diturisë, e nëse shoqërohet me njerëz, do ta konsiderojë se ka humbur kohë, i janë shumëfishuar të metat dhe i janë trazuar ibadetet.

Të gjitha këto që i cekëm janë kokëçarje të fshehta, të cilave duhet t’i druheni.

DOBIA E SHTATË

Dobia e shtatë është përvoja, e cila përfitohet përmes shoqërimit me njerëz dhe me hulumtimin e gjendjeve të tyre. Mendja e brishtë nuk është e aftë që të kuptojë edhe punët e fesë edhe të dynjasë. Për këtë duhet përvojë dhe praktikë. Nuk ka dobi nga vetmia e atij të cilin përvoja nuk e ka mësuar asgjë. Nëse fëmiu vetmohet, ai rritet i paditur. Ai së pari duhet të mësojë, e duke mësuar, në kontakt me të tjerët, fiton edhe përvojën e nevojshme. Kjo do t'i jetë e mjaftueshme, e përvojën tjetër e fiton duke dëgjuar për gjendjet e të tjerëve, për çka gjithashtu i duhet shoqërimi me njerëz.

Nga përvojat më të rëndësishme i është ta sprovtojë nefsën e vet, ahlakun dhe vetitë e fshehta. E kjo është e vështirë të bëhet në vetmi, sepse edhe ai që ka urrejtje dhe është smirëzi, derisa është në vetmi nuk i sjell dëm të tjerëve dhe nuk i bartë të metat e veta tek tjetri. Këto kuptohen vetëm në mesin e njerëzve.

Pra, këto janë veti të rrezikshme, që duhet të eliminohen. Nuk mjafton që vetëm të distancohemi nga çdo gjë që i nxitë këto. Është simbolikë e drejtë që zemra e ngarkuar me këto ndyrësi të krahasohet me plagën e mbushur me kelb e gjak të ndyrë. Ai që ka plagë të tillë, nëse kelbi nuk zgjerohet dhe nuk

ngucet, nuk do të ndjejë dhimbjen e saj. Bile, në raste të caktuara ai mund të mendojë se është i shëndoshë. Ai nuk e ndjen prezencën e kelbit dhe mendon se nuk e ka fare. Mirëpo nëse dikush e prek në plagë, atëherë do të pëlçet i gjithë kelbi nga plaga dhe do të derdhë gjithë atë ndjesi të keqe me të cilën ishte i ngarkuar. Njejtë ndodhë edhe me zemrën që është e mbushur me gjëra të këqia si koprracia, varësia, urrejtja dhe të meta të tjera; do të pëlçet kelbi nga këto plagë vetëm nëse nxitet ndonjë gjë që i prek këto plagë në brendësinë e tij.

Prandaj udhëtarët shpirtërorë që janë angazhuar me pastrimin e zemrës duhet të hulumtojnë se a e kanë këtë sëmundje në vete. Ai që në vete ndjenë se ka një dozë të mendjemadhësisë, duhet të angazhohet menjëherë në menjanimin e saj. Disa kanë bartur sasi të mëdha të ujit në shpinë, disa të tjerë sasi të drunjëve mbi kokë, dhe në këtë gjendje kanë kaluar nepër çarshi. Me këtë e kanë luftuar neftin e vet. Vërtetë, të keqijat e neftit dhe lojërat e shejtanit janë të fshehta. E të paktë janë ata që i njohin këto të këqija. Dikush tregonte:

“Kam falë namaz për tridhjetë vite rresht, në safin e parë. Një ditë u vonova dhe mbeta në saf të dytë. Ndjeva mërzi që mbeta në safin e dytë, dhe mendova: “Të më shohim mua në saf të dytë; kjo për mua është turp!” Atëherë e kuptova se namazet e

mia kishin qenë të mbështjella me hipokrizi (rija) dhe se unë merrja kënaqësi nga shikimet e njerëzve, kur më shihnin ndër të parët që vrapojnë pas hairit.”

Shoqërimi me njerëz përmbanë në vete dobi të mëdha, duke i shfaqur sëmundjet e fshehta të njeriut. Andaj edhe thuhet se udhëtimi (*sefer*) shfaq moralin e njeriut. Udhëtimi është një ndër mënyrat e shoqërimit të përhershëm me njerëz. Për të kuptuar rreziqet dhe hollësitë e tyre, do të ketë shpjegim të veçantë në librin *‘Rub’u’l – Muhlikat’*, kur do të flasim për gjërat që shpien në shkatërrim. Mosdija e këtyre hollësive bëhet shkak për shkatërrim të shumë veprave. E përmes diturisë sigurohen shumë dobi, me pak veprim. Po të mos ishte kështu, dituria nuk do të ishte më e vlefshme se vet veprimi. Është absurde që dituria e përfitur për faljen e namazit të jetë më e vlefshme se sa falja e namazit me atë dituri. Sheriati e ka përcaktuar se dijetari është më me vlerë se sa abidi, andaj Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Vlera e dijetarit ndaj abidit është si vlera ime ndaj as’habit tim në shkallën më të ulët.”⁴⁸

Vlera e diturisë ndaj veprimit mund të shikohet nga tri aspekte. Njërin veç e kemi përmendur. I dyti aspekt ka të bëjë me dobinë e përgjithshme të diturisë, përderisa dobia e veprimit është e veçantë.

⁴⁸Tirmidhi, nga Ebu Umame.

E në aspektin e tretë, me dituri mendohet në njohjen e Allahut Teala, cilësive dhe veprave të Tij. E kjo dituri është më e mirë se çdo vepër. Në fakt, qëllimi i veprimit është njohja e Allahut Teala dhe dashuria ndaj Tij; kthimi i zemrës, prej krijesave kah Krijuesi. Për këtë qëllim nevojitet edhe dituria për veprim edhe veprimi. Prandaj kjo dituri është qëllim i muridit, e veprimi është kusht i kësaj diturie.

Këtë e dëshmojnë edhe fjalët e Allahu Teala:

“... te Ai ngrihet fjala e mirë, e fjalën e mirë e ngritë veprimi i mirë.”³⁵-Fatir: 10

Fjala e mirë është kjo dituri, derisa veprimi është si hamall (bartës) që e bartëkëtë Allahut Teala. Andaj ajo që bartet është më me rëndësi nga ajo që bartë. Por kjo nuk është tema jonë, e t'i kthehemi qëllimit:

Pasi je njoftuar me dobitë dhe dëmet e vetmisë, e ke të qartë se sa gabim është të gjykohet për dobinë apo dëmin absolut të vetmisë. Në fakt, duhet të shikohet konkret në personin dhe në gjendjen e tij, në atë se me kë shoqërohet dhe gjendjen e personit me të cilin shoqërohet, arsyen se përse shoqërohen, si edhe fakti që, nëse nuk kontakton me njerëz - do të largohej nga rruga e dobive të lartëpërmendura. Ajo çfarë do të lëshojë krahasohet me atë që do t'a fitojë. E atëherë kuptohet se çfarë është e drejtë, dhe bëhet e qartë se cila është më e mirë.

Imam Shafiu, Allahu e mëshiroftë, ka folur shkëlqyeshëm kur ka thënë:

“O Junus! Mos e tharto fytyrën para njerëzëve; kjo bëhet sepse për armiqësi. E buza e qeshur bëhet sepse për miq të këqij. Prandaj qëndro mes dyjave.”

Andaj duhet të jemi të matur edhe në shoqërimin me njerëz e edhe në vetmi. E gjithë kjo dallon nga rasti në rast. Duke i menduar dobitë dhe dëmet, do të kuptohet më e mira.

Qe, kjo është e vërteta e qartë. Çdo shpjegim tjetër është i mangët. Secili e ka shpjeguar gjendjen e vet, e nuk është e drejtëqë gjykim i njëjtë të jepet edhe për të tjerët.

Dallimi mes dijetarit dhe sufiut në gjendjen e jashtme (zahir) qëndron pikërisht këtu. Sufiu përgjigjet sipas gjendjes së vet, kurse dijetari e njëjtit situatën ashtu siç është, nuk i kushton vëmendje gjendjes së vet, dhe e shpjegon të vërtetën. Kjo është ajo *e vërteta* që nuk pranon mospajtime. E vërteta është gjithmonë një, por ata që nuk mund ta njohin janë aq të shumtë, sa nuk mund të numërohen.

Kur janë pyetur sufitë për varfërinë, secili është përgjigjur ndryshe. Bazuar në gjendjen në të cilën ata ndodhen, secila përgjigje është e drjetë, por ato nuk janë *e vërteta* si e tillë, sepse *e vërteta* (hak) është vetëm një.

Andaj Ebu Abdullah el-Xheli, kur është pyetur për varfërinë ka thënë: *“Gjithçka që ke brenda vetes hudhe dhe thuaj: ‘Rabbi im eshte Allahu!’ Eh, kjo është varfëria.”*

Khunejd Bagdadi ka thënë: *“I varfër është ai që nuk kërkon asgjë dhe nuk kundërshton asgjë, e nëse i kundërvihen, ai hesht.”*

Sehl ibn Abdullahu ka thënë: *“I varfër është ai që nuk kërkon dhe nuk mbledhë.”*

Edhe një tjetër ka thënë: *“Varfëria është mosposedimi i asgjëje, e nëse posedon, padyshim që nuk është e jotja.”*

E Ibrahim el-Havvas ka thënë: *“Varfëria është braktisja e ankesave dhe mosparaqitja e nevojave.”*

E po të pyeteshin edhe njëqind të tjerë lidhur me varfërinë, do të dëgjoheshin edhe njëqind përgjigje nga më të ndryshmet. Rrallë që dy prej tyre përputhen. Mirëpo çdo përgjigje është e drejtë nga një kënd-vështrim. Çdo përgjigje apo shprehje është pasqyrim i gjendjes personale dhe i asaj se çfarë zotërojnë ata në zemrat e tyre.

Andaj, asnjëri prej tyre nuk e pranon përparësinë e tjetrit në tasavvuf dhe nuk e lavdëron tjetrin. Secili pretendon se e ka arritë të vërtetën dhe se e njej hakikatin. Sepse ata në përgjithësi veprojnë sipas gjendjes së tyre, nuk merren me asgjë tjetër përveç vetes se tyre, dhe nuk shikojnë tek të tjerët.

E kur drita e diturisë shkëlqen, ajo mbulon gjithçka, dhe duke e hjekur perden e hakikatit, e bën të qartë ndryshimin. Shembulli i tyre është sikur mendimete ndryshme në lidhje me kohën e namazit të drekës. Njëri do të thotë se koha e namazit në verë është kur zgjatet hija dy pëllëmbë. Tjetri do thotë se është gjysmë pëllëmbë. I treti thotë: *“Jo, dimrit është shtatë pëllëmbë.”*, e i katërti do thotë se është pesë pëllëmbë. E dikush tjetër do t’i kundërshtojë të gjitha këto. Kjo i ngjanë përgjigjeve të sufijve dhe dallimeve mes tyre. Edhe këtu, secili flet për hijen në bazë të asaj se si ai e sheh nga vendi i tij. Por ata kanë gabuar duke i kundërshtuar të tjerët, duke supozuar se e tërë bota është e njëjtë me mjedisin e tyre. Ashtu edhe sufiu, konkludimin për botë e sjellë në bazë të gjendjes së vet. Ndërsa ai që i di pozitat e caktuara të diellit në kohë të ndryshme, është ai që e di edhe arsyen për gjatësinë dhe shkurtësinë e hijes - arsyen e mospërputhjes në vende të ndryshme. Prandaj edhe sjellë gjykime në bazë të rajoneve të ndryshme. Dhe ai do të tregojë se si në disa rajone hija nuk vërehet aspak, në të tjerat është e gjatë, e në tjerat e shkurtër.

Pra, kjo është ajo që kemi dashur të tregojmë lidhur me dobitë e vetmisë dhe të shoqërimit me njerëz.

Po të pyesësh: *“Për atë që zgjedh vetminë dhe atë e sheh si rrugë më të sigurtë e më të mirë për vete, cilat mund të jenë rregullat (edebi) e vetmisë për të?”*, në këtë pyetje përgjigjemi në bazë të librit *‘Edukata në miqësi.’* Por, mos t’a zgjasim:

Ai që preferon tërheqjen në vetmi duhet që qëllim të vetmisë së tij të ketë shpëtimin e njerëzve nga e keqja e tij, shpëtimin e tij nga punët e liga, shpëtimin nga pamundësia për të mbrojtur të drejtat e myslimanëve, dhe qëllim për ibadet me vëmendje.

Këto janë edebet e nijetit.

Pas kësaj, kur është në vetmi, njeriu duhet t’i japë rëndësi diturisë, veprimit, dhikrit dhe meditimit, për të fituar dobinë e vetmisë. Për të mos humbë kohën, nuk duhet të pranojë shumë vizitorë, nuk duhet të pyes shumë rreth gjendjeve të njerëzve. Të mos i kushtojë vëmendje tregimeve që fliten në qytet dhe as asaj se me çfarë merren njerëzit, sepse e gjithë kjo i ngjitet në zemër dhe aktivizohet gjatë namazit e meditimit. Marrja e lajmit përmes dëgjimit është sikur mbjellja e farës në tokë. Nuk ka dyshim se këto lajme do të tregojnë frytet e tyre dhe do ta shtyejnë njëra-tjetrën që të ndikojnë tek njeriu.

Një ndër gjërat më me rëndësi për atë që tërhiqet në vetmi është të mos i kushtojë vëmendje vesveseve të cilat e pengojnë nga dhikri, e lajmet që i merr nga njerëzit janë burim i vesveseve.

Duhet të kënaqet me gjërat e mjaftueshme për jetë, përndryshe është i detyruar të shoqërohet me njerëz. Duhet të jetë i durueshëm ndaj zullumit dhe padrejtësisë që i përjeton nga fqinjët. Duhet të mbyllë veshët për lavdërime ose kritika rreth tërheqjes së tij në vetmi; çdo gjë që mund të ndikojë në zemër, qoftë edhe për kohë të shkurtë, e largon nga rruga e ahiretit.

Udhëtimi shpirtëror është i mundur vetëm me zemër të qetësuar me dhikër të vazhdueshëm, ose me *tefekkur* (mendim) rreth Madhësisë dhe Fuqisë Absolute të Allahut Teala, Cilësive të Tij, krijesave që i ka krijuar, qiejve e tokës, mrekullive të dukshme e të fshehura, ose tefekkur rreth hollësirave të veprimit, a sëmundjeve të zemrës dhe mbrojtjes nga to.

Për të gjitha këto nevojitet qetësi dhe kohë e lirë. Interesimi për gjërat që u cekën më lartë vjen në kujtim bile edhe gjatë dhikrit. Prandaj duhet larguar nga to.

Duhet të ketë grua fetare ose një mik fetar me të cilin mund të bisedojë bile një orë në ditë, për të pushuar nga ngarkesa e ibadetit të vazhdueshëm. Një pushim i tillë ndihmon për të vazhduar ibadetin.

Durimi nuk do të jetë i plotë në vetmi derisa nuk i ndërpret aspiratat ndaj dynjasë dhe gjërave pas të cilave njerëzit ngarendin. E lakmia nuk do të

ndërpritet derisa nuk ndërpriten shpresat, sepse nuk është e mundur të jetohet aq gjatë. Në fakt, duhet t'ia nis ditës me shpresën se nuk do ta pret përfundimin e ditës, dhe të përfundojë ditën me shpresë se nuk do ta përjetojë ditën e nesërme. Ashtu do ta ketë më lehtë dhe i rritet durimi. Por nuk do ta ketë të lehtë nëse veç paraprakisht vendos që të bëjë durim njëzet vite, nëse veç mundet disi t'ia lehtësojë ky afat.

Dikush shpesh kujton vdekjen dhe vetminë në varr. Kurdo që zemra i shtrëngohet nga vetmia le ta dijëse ai që nuk fiton afërsinë e Allahut Teala me dhikër dhe marifet, nuk mund të përballlet as me vetminë pas vdekjes. E ai qënë saje të dhikrit dhe marifetit fiton afërsinë e Allahut Teala, duhet të jetë i bindur se vdekja nuk mund ta shkatërrojë këtë afërsi. Vdekja nuk e prishë vendin e afërsisë dhe marifetit. Ato qëndrojnë në gëzim me mirësinë dhe mëshirën e Allahut Teala.

Ndërsa Allahu Tealapër shehidët thotë:

“Kurrresi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Rabbi i tyre.

Janë të gëzuar me atë që u dha Allahu nga të mirat e Tij” 3 – Ali Imran: 169,170

Secili që përmes luftës ndaj nefsit i përkushtohet Allahut Teala, dhe vdes në këtë gjendje, është shehid. Sipas kësaj, muxhahid i vërtetë është ai i cili lufton me nefsin, ashtu siç shpjegon Resulallahu s.a.v.s:

“Muxhahid është ai që lufton me nefsin dhe pasionin.”⁴⁹

Lufta (xhihad) më e madhe është lufta me nefsin. Disa as’habë kanë thënë: **“U kthjem prej xhihadit (luftës) të vogël në xhihad të madh”**; e me këtë kanë menduar në xhihadin (luftën) e nefsit.

Këtu mbaron *Libri mbi Vetminë*. Pason *Libri mbi Edebet e Udhëtimit*.

Hamdi i takon vetëm Allahut Teala.

⁴⁹ Hakim nga Fudale b. Ubejdi.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
MENDIME RRETH VETMISË	5
DËSHMITË E ATYRE QË PREFEROJNË SHOQËRIMIN DHE DOBËSITË E KËTYRE DËSHMIVE	11
DESHMITË E ATYRE QË PREFEROJNË VETMINËDHE DOBËSITË E KËTYRE DËSHMIVE	17
SHPJEGIMI I DOBIVE DHE DËMEVE TË VETMISË	23

